



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 127

Tiranë – E martë, 12 korrik 2016

## PËRMBAJTJA

|  | Faqe  |       |
|--|---|-------|
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 94, datë 17.6.2016  | Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e metodologjisë së llogaritjes së dëmit ekonomik nga operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes.....  | 10331 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 95, datë 17.6.2016  | Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike” .....  | 10331 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 96, datë 17.6.2016  | Mbi miratimin e rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” .....  | 10331 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 97, datë 17.6.2016  | Mbi miratimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.....   | 10343 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 98, datë 17.6.2016  | Mbi miratimin e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....  | 10348 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 100, datë 17.6.2016 | Mbi fillimin e proceduarve për miratimin e kontratës TIP për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit e shërbimit universal..... | 10353 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 101, datë 23.6.2016 | Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80 date 23.10.2009, të ndryshuar.....                                     | 10354 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 102, datë 23.6.2016 | Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat.....  | 10362 |

|   |   |       |
|---|---|-------|
| Vendim i Entit Rregullator<br>të Energjisë, nr. 103, datë 23.6.2016 | Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik..... | 10363 |
| Vendim i Entit Rregullator<br>të Energjisë, nr. 104, datë 23.6.2016 | Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr.49, datë 21.10.2004, dhe nr. 146, datë 24.12.2013.....                       | 10369 |
| Vendim i Entit Rregullator<br>të Energjisë, nr. 105, datë 23.6.2016 | Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores “Për përcaktimin/klasifikimin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike” .....   | 10370 |

**VENDIM****Nr. 94, datë 17.6.2016**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR  
SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E  
METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË  
DËMIT EKONOMIK NGA OPERATORI I  
SISTEMIT, SI PASOJË E NDËRHYRJEVE  
TË PALIGJSHME NË SISTEMIN E  
SHPËRNDARJES**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, nenit 68, nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe në zbatim të nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.6.2016, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike të ERE-s, në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së dëmit ekonomik nga operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes”,

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së dëmit ekonomik nga operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 95, datë 17.6.2016**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR  
SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E  
RREGULLORES “PËR KUSHTET  
MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT  
TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, nenit 16, nenit 20, germa “g”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 25 të “Rregullave

të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.6.2016, pasi shqyrtoi relacionin e drafttregullores “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e drafttregullores “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 96, datë 17.6.2016**

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES  
PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN  
DHE PROCEDURAT E ERE-s**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.6.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës, për rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s dhe relacionin përkatës,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rregulloren e organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE-s (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**



## RREGULLORE

### PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE PROCEDURAT E ERE-s

#### PJESA I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1 Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 16, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

##### Neni 2 Qëllimi i rregullores

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë procedura transparente në ushtrimin e funksioneve të ERE-s, duke garantuar një trajtim të barabartë në dhënien e licencave, kualifikimeve dhe certifikimeve në sektorin e energjisë elektrike, vendosjen e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në aktivitetet e rregulluara, zgjidhjes së konflikteve midis të licencuarve dhe midis të licencuarve dhe klientëve, hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

##### Neni 3 Zbatimi

1. Kjo rregullore përcakton procedurat e përgjithshme që aplikohen nga ERE gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, lidhur me:

- drejtumin dhe funksionimin e ERE-s;
- trajtimin e aplikimeve për dhënie licence, kualifikim dhe certifikim në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror;
- trajtimin e aplikimeve për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror;
- hartimin dhe rishikimin e akteve nënligjore;
- zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- zhvillimin e seancave dëgjimore;
- trajtimin e kërkesave të të licencuarve;
- trajtimin e ankesave të klientëve;

i) trajtimin e aplikimeve për miratim të planit të investimeve nga të licencuarit.

2. Procedurat që nuk rregullohen në mënyrë specifike nga këto rregulla, do të rregullohen nga Kodi i Procedurave Administrative.

##### Neni 4 Parime të përgjithshme

Këto rregulla zbatohen duke pasur parasysh parimet e:

- pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi;
- eficiensës në punë të personelit të ERE-s;
- mundësisë për seanca dëgjimi të plota dhe të drejta për të gjitha palët e interesuara;
- procesit transparent dhe të hapur.

##### Neni 5 Përkufizime

Në këto rregulla, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

1. **“ERE”** do të thotë Enti Rregullator i Energjisë është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe i gazit në Shqipëri.

2. **“Bordi”** do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara në ligj.

3. **“Kryetari i ERE-s”** është administratori i përgjithshëm i ERE-s, përgjegjës për administrimin e institucionit dhe drejtumin e mbledhjeve të Bordit.

4. **“Personeli teknik dhe ai ndihmës e mbështetës”** do të thotë punonjësit e ERE-s, si dhe çdo këshilltar ose ekspert i kontraktuar në përputhje me strukturën organizative të miratuar nga Bordi i ERE-s.

5. **“Person drejtues”** ose **“Relatues”** do të thotë personi i caktuar të drejtë një procedim të ERE-s, me detyrat dhe kompetencat e parashtruara në këtë rregullore. Drejtuesi i një procedimi mund të jetë një anëtar i Bordit ose një anëtar i personelit teknik të ERE-s, siç është vendosur nga kryetari.

6. **“Sekretar/e”** do të thotë sekretari i organit vendimmarrës.

7. **“Rregullat”** do të thotë rregullore për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s.

8. **“Person”** do të thotë çdo person fizik ose juridik, qeveria ose çdo agjenci shtetërore, çdo autoritet lokal ose ente të tjera juridike.

9. **“Licencë”** do të thotë një e drejtë e dhënë nga ERE-ja, një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike ose atë



të gazit natyror, në përputhje me dispozitat që kërkohen nga ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për gazin natyror”, si dhe procedurave të licencimit të ERE-s.

**10. “I licencuar”** do të thotë një person i pajisur me një licencë të dhënë nga ERE për aktivitete në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

**11. “Klient”** është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.

**12. “Klient familjar”** është një klient që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregtare apo profesionale.

**13. “Klient fundor”** është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

**14. “Klient jofamiljar”** janë personat fizikë ose juridikë që blejnë energji elektrike, e cila nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës.

**15. “Klient i vogël jofamiljar”** është një person fizik apo juridik, i lidhur në nivel tensioni 0,4 kv, i cili blen energji për përdorim në mjediset ku ai ushtron aktivitetin e tij dhe jo për qëllim rishitjeje.

**16. “Klient shumice”** është një person fizik ose juridik që blen energji elektrike, me qëllim rishitje brenda ose jashtë sistemit të vendit ku është regjistruar.

**17. “Klient në nevojë”** është një klient familjar, i cili për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në raste përjashtimore sipas përcaktimeve të këtij ligji.

**18. “Klient i gazit natyror”** do të thotë një person që furnizohet me gaz nga një furnizues i gazit natyror.

**19. “Kërkesë”** do të thotë një kërkesë me shkrim e paraqitur në ERE, nga një person për një çështje, që është objekt i rregullimit nga ERE.

**20. “Aplikues”** do të thotë çdo person, i ndryshëm nga ankuesi, i cili paraqet një kërkesë që është nën autoritetin e ERE-s.

**21. “Ankues”** do të thotë një person që depoziton një ankesë në ERE, për çdo veprim ose mosveprim të një personi, që është në juridiksionin e ERE-s, për aktivitetin që kryen siç parashikohet në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

**22. “I ankimuar”** do të thotë një person i licencuar, kundër të cilit është paraqitur një ankesë ose ka filluar një hetim nga ERE.

**23. “Palë e interesuar”** do të thotë një person që merr pjesë në një procedurë të caktuar ERE-s.

**24. “Paraqitja e tarifave dhe çmimeve”** konsiston në tarifat dhe çmimet e propozuara dhe materialet e tjera që shoqërojnë aplikimin e paraqitur në ERE, për miratim nga aplikuesi përkatës në përputhje me këto rregulla, si dhe me metodologjinë përkatëse të tarifave.

**25. “Tarifat dhe çmimet”** janë pagesat që duhet të kryhen nga klientët ose përdoruesit e sistemeve për shërbimet e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, që sigurohen nga shoqëritë e licencuara nga ERE, që ushtrojnë veprimtari të rregulluar në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike apo gazit natyror mund të rishikohen nga ERE, me propozim të licencuarve ose me iniciativën e vet ERE-s, sipas parimeve të parashikuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” .

**26. “Terma dhe kushte”** do të thotë dispozita të miratuara nga ERE ndaj një të licencuari, që siguron një ose disa shërbime në sektorin e energjisë elektrike apo atë të gazit natyror, sipas të cilave do t'i sigurohet shërbimi ose shërbimet e klientëve.

**27. “Vit testimi”** është një periudhë 12-mujore e përdorur nga një i licencuar, që siguron një shërbim ose disa shërbime të energjisë elektrike apo gazit natyror, si bazë për krahasimin e të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve, i cili do të ndihmojë ERE-n në llogaritjen e të ardhurave në një procedurë për miratim tarifash. Një vit testimi mund të jetë një vit kalendarik ose çdo periudhë tjetër prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm. Specifikisht, vit testimi u referohet përcaktimeve sipas metodologjive të llogaritjes së tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike, miratuar nga ERE.

**28. “Ditë e rregullt pune”** do të thotë një ditë që nuk është e shtunë, e diel ose festë zyrtare e parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

**29. “Akt individual”** do të thotë çdo vendim që krijon pasoja juridike individualisht.

**30. “Akt normativ”** do të thotë çdo vendim që krijon pasoja juridike për më shumë se një individ.



**31. “Aktivitete të rregulluara”** do të quhen të gjitha aktivitetet e sektorit të energjisë elektrike të parashikuara si të tilla në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

## PJESA II

### ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ERE-s

#### Neni 6

#### **Përbërja e ERE-s**

1. Enti Rregullator i Energjisë përbëhet nga 5 anëtarë të Bordit, një nga të cilët është kryetari i ERE-s, si dhe nga personeli teknik dhe joteknik, i cili emërohet dhe promovohet në detyrë sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i ERE-s rregullohet nga rregullorja e miratuar nga Bordi, sipas nenit 11, pika 7, të ligjit nr. 43/2015.

#### Neni 7

#### **Drejtimi i ERE-s**

1. Organet drejtuese të ERE-s janë Bordi dhe kryetari i ERE-s.

2. Bordi është organi vendimmarrës i ERE-s, që përcakton drejtimet kryesore të veprimtarisë së ERE-s dhe vendos për çështjet që kërkojnë miratimin e ERE-s. Ai vepron si organ kolegjal.

3. Anëtari i Bordit mund të vendosë të mos votojë për çështje të ndryshme kur ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kryetari i ERE-s është administratori i përgjithshëm i ERE-s, përgjegjës për administrimin e institucionit dhe drejtimin e mbledhjeve të Bordit.

5. Kryetari thërret dhe drejton mbledhjet e Bordit dhe është përgjegjës për publikimin e vendimeve të Bordit. Në rastet kur kryetari i Bordit mungon në detyrë, ai autorizon një nga anëtarët e Bordit që të ushtrorë funksionin e kryetarit gjatë kësaj periudhe.

## PJESA III

### RREGULLAT E ZHVILLIMIT TË MBLEDHJEVE TË BORDIT

#### Neni 8

#### **Mbledhjet e Bordit**

1. Me qëllim organizimin e punës në ERE dhe planifikimin e detyrave dhe përgjegjësive të ERE-s në ushtrimin e autoritetit ligjor, Bordi zhvillon mbledhje të paktën 1 herë në muaj.

2. Si rregull, mbledhjet mbahen në zyrat e ERE-s. Në rast se mbledhjet mbahen në një vend tjetër, ky tregohet në njoftimin e mbledhjes.

3. Kryetari i ERE-s vendos për thirrjen e mbledhjes së Bordit. Në mungesë të tij, mbledhja thirret nga anëtari i Bordit i caktuar përkohësisht nga kryetari për drejtimin e ERE-s.

4. Përpara çdo mbledhje të Bordit, kryetari përgatit një agjendë të çështjeve për t'u shqyrtuar në Bord. Sekretari/ja ua shpërndan këtë agjendë, anëtarëve të Bordit, si dhe drejtorive që kanë ndjekur një procedurë. Kjo agjendë është e disponueshme për publikun në zyrat e ERE-s dhe në faqen e internetit të saj.

5. Njoftimi i mbledhjes, komunikohet anëtarëve të Bordit të paktën 5 ditë kalendrike përpara datës së caktuar për mbledhjen.

6. Afati i përcaktuar në pikën 5 të këtij neni nuk zbatohet nëse në aktet e tjera ligjore që kanë fuqi detyruese për ERE-n përcaktohen afate të ndryshme. Në këtë rast, agjenda dhe materialet shoqëruese të nevojshme për vendimmarrje do t'i dërgohen Bordit të paktën 24 orë para mbledhjes së Bordit.

7. Me kërkesën e një prej anëtarëve të tij, Bordi mund të vendosë të heqë ose shtojë çështje të veçanta nga agjenda e përgatitur.

#### Neni 9

#### **Mbledhjet jashtë radhe**

Përveç mbledhjeve të zakonshme, që i referohen nenit 8 të këtyre rregullave, çdo anëtar i Bordit mund të marrë iniciativën për të organizuar një mbledhje të Bordit, duke i dorëzuar kryetarit një kërkesë me shkrim, që përfshin agjendën dhe çështjet që do të jenë objekt i mbledhjes të paktën tri ditë përpara datës kur kërkohet mbledhja. Kryetari brenda 24 orëve do të njoftojë më pas anëtarët e tjerë të Bordit dhe sekretarin/en për këtë takim dhe do të marrë masa për zhvillimin e mbledhjes të kërkuar, jo më vonë se 2 ditë pune nga dërgimi i njoftimit anëtarëve të Bordit.

#### Neni 10

#### **Mbledhjet e hapura**

Përveç mbledhjeve lidhur me çështje që janë objekt i brendshëm i ERE-s, të gjitha mbledhjet e Bordit do të jenë të hapura për publikun. Mbledhjet e hapura për publikun zhvillohen sipas përcaktimeve të neneve në vijim.



## Neni 11

**Njoftimi i mbledhjes**

ERE, siguron njoftimin për publikun 48 orë para zhvillimit të një mbledhjeje të hapur të programuar të Bordit të ERE-s. Njoftimi përmban datën, orën, vendin e zhvillimit të mbledhjes, si dhe rendin e ditës. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes vendoset në një vend të posaçëm në hyrje të ERE-s, si dhe publikohet në faqen zyrtare të ERE-s, në internet.

## Neni 12

**Organizimi i mbledhjes së hapur**

1. Para fillimit të çdo mbledhje vendimmarrëse të Bordit, sekretarja regjistron në një regjistër të posaçëm emrat e personave, që kërkojnë të marrin pjesë në mbledhje. Çdo person do të depozitojë pranë sekretarisë kërkesën për pjesëmarrjen në mbledhje, jo më vonë se 24 orë para datës të njoftuar të mbledhjes.

2. Në momentin e hapjes së mbledhjes, sekretarja u bën të njohur pjesëmarrësve nëpërmjet leximit, procedurat e zhvillimit të mbledhjes, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre.

3. Në një mbledhje të hapur të Bordit kanë të drejtë të diskutojnë dhe të japin mendime, vetëm anëtarët e Bordit dhe përfaqësuesit e ERE-s, si dhe me leje të kryetarit të ERE-s, edhe persona të tjerë që kanë lidhje me çështjet në agjendë.

4. Me kërkesë të palëve të interesuara, sekretarja e Bordit u lejon atyre që të njihen me vendimin e Bordit pas zbardhjes së tyre.

## Neni 13

**Të drejta e detyrime të publikut**

1. Gjatë zhvillimit të një mbledhje vendimmarrëse të Bordit, çdo person që do të marrë pjesë ka të drejtë të dëgjojë e të mbajë shënime, por nuk ka të drejtë të flasë apo të bëjë pyetje, me përjashtim të rasteve kur drejtuesi i mbledhjes e lejon një gjë të tillë. Ndalohet, gjithashtu, ndërprerja e fjalës së folësit, përdorimi i celularëve dhe pirja e duhanit gjatë një mbledhjeje.

Mbledhjet e hapura të Bordit mund të regjistrohen nga përfaqësues të autorizuar të shtypit të shkruar dhe audiovizive mbas miratimit të kryetarit.

2. Nëse ndonjë nga personat pjesëmarrës në mbledhjen e Bordit konsiderohet se prish qetësinë dhe mbarëvajtjen e mbledhjes, drejtuesi i mbledhjes urdhëron largimin e tij nga mbledhja.

3. Kryetari mbas konsultimit me Bordin vendos, për ndërprerjen e mbledhjes për një periudhë të caktuar kohe ose shtyrjen e saj pas marrjes së miratimit nga Bordi.

## Neni 14

**Zhvillimi i mbledhjes dhe materialet e nevojshme**

1. Në mbledhjet e Bordit, si rregull marrin pjesë anëtarët e Bordit, personeli teknik që ka shqyrtuar e përpunuar një çështje të caktuar në rendin e ditës, këshilltarët e Bordit apo ekspertët, si dhe persona të tjerë të interesuar, si dhe çdo punonjës tjetër i ERE-s, kërkuar nga Bordi.

2. Në çdo rast të zhvillimit të mbledhjeve çështjet e përcaktuara në rendin e ditës së mbledhjes duhet të kenë materialin shoqërues si më poshtë:

- relacionin/informacionin argumentues;
- projektvendimin në rastet e propozimeve për vendimmarrje;
- materiale të tjera të nevojshme për vendimmarrjen e Bordit.

Përcaktimi i personelit teknik që do të merret me hartimin e relacionit/informacionit argumentues, si dhe procedura e dorëzimit dhe përgjegjësia për to, do të rregullohet nga rregullorja e funksionimit të brendshëm të ERE-s.

3. Për çështjet e karakterit informues materiali shoqërues do të konsistojë në paraqitjen e një relacioni informues për Bordin.

4. Në rast se çështjet e parashikuara kërkojnë kohë për shqyrtimin e tyre në mbledhje, me vendim të Bordit, mund të caktohet zhvillimi i saj në një datë tjetër.

5. Për çdo mbledhje të Bordit sekretari/ja i/e Bordit do të mbajë procesverbalin e mbledhjes, i cili detyrimisht do të përmbajë informacion lidhur me vendin, kohën e fillimit të mbledhjes, agjendën dhe ndryshimet e mundshme të ndodhura në të, anëtarët e Bordit prezentë ose që mungojnë, personat e tjerë të thirrur për të marrë pjesë, të cilët janë prezentë ose mungojnë, diskutimet e personave pjesëmarrës në mbledhje, rezultatet e votimit, konkluzionet e mbledhjes, si dhe çdo informacion të diskutuar gjatë mbledhjes.

6. Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit, me përjashtim të informacionit të trajtuar nga Bordi me karakter konfidencial apo sekret, janë të hapura për publikun.



7. Të gjitha mbledhjet e Bordit të regjistruhen në audio.

Neni 15

#### **Vendimmarrja**

1. Mbledhjet e Bordit zhvillohen me pjesëmarrjen e jo më pak se tre anëtarëve dhe vendimet merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të Bordit. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese. Votimi i Bordit është i hapur dhe vetëm përjashtimisht kur Bordi vendos ndryshe, votimi kryhet i fshehtë. Vendimet e Bordit hartohen në tri kopje të nënshkruara nga secili anëtar i Bordit dhe ruhen në zyrën e sekretarisë, zyrën e arkivit dhe në drejtorinë përgjegjëse, siç është përcaktuar në rregulloren e organizimit të brendshëm.

2. Të gjitha vendimet e Bordit, që botohen në Fletoren Zyrtare vulosen me vulën e ERE-s dhe firmosen nga kryetari i Bordit dhe sekretari/ja.

3. ERE do t'u dërgojë njoftim me shkrim të gjitha palëve të interesuara për vendimet e Bordit, brenda 3 ditëve pune nga zbardhja e vendimit. Të gjitha vendimet e ERE-s regjistruhen në regjistrin zyrtar të vendimeve, i disponueshëm për shqyrtim nga publiku.

Neni 16

#### **Ridëgjimi dhe ankimi kundër vendimit të Bordit**

1. Për një vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve pune nga data e marrjes dijani të vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja, që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

2. Bordi do të shqyrtojë provën e re dhe do të nxjerrë vendimin e tij brenda 30 ditëve kalendarike, nga paraqitja e kërkesës për rishikim. Kërkesa për rishikim nuk do të lejojë personin që paraqet kërkesën të ndërpresë ekzekutimin e vendimit të parë të Bordit brenda afateve të përcaktuara, përveç kur është pezulluar nga Bordi nën autoritetin e tij.

3. Kërkesa për rishikim vendimi nuk pezullon zbatimin e vendimit, me përjashtim kur, Bordi vendos ndryshe.

4. Pezullimi i aktit të miratuar nga ERE bëhet vetëm nga Bordi, sipas një kërkesë të paraqitur nga një subjekt i interesuar, në përputhje me rrethanat specifike.

5. Bordi nuk mund të vendosë për pezullimin e zbatimit të një akti të tij, në rastet kur:

- pezullimi i aktit ndalohet me ligj;
- zbatimi i menjëhershëm i tij është në interes publik.

Neni 17

Çdo person, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe ligjin nr. 9646 datë 30.6.2008, "Për gazin natyror", mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

#### **PJESA IV**

#### **REGJISTRIMI DHE DOKUMENTIMI**

Neni 18

#### **Regjistrimi i aplikimit apo kërkesës**

1. Punonjësi i protokollit hap një dosje për çdo procedurë, për të cilin këto rregulla janë të aplikueshme, përfshirë ankesat, kërkesat, procedurat e tarifave, çmimeve, licencave, kualifikimeve, certifikimeve dhe relacionet argumentuese në lidhje me një amendament, shtojcë, përfundim, rinovim, heqje të licencës etj. Çdo procedim do të ketë një numër të caktuar në regjistrin e protokollit dhe do t'i bashkëlidhet kartelës shoqëruese, siç përcaktohet në rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ERE-s". Për dokumente të të njëjtit procedim krijohet dosja përkatëse nga zyra e protokollit në bashkëpunim me drejtorinë e ngarkuara për trajtimin e kërkesës apo aplikimit. Punonjësi i protokollit mban një listë për të gjitha procedurat e futura në dosje dhe siguron një kopje të kësaj liste falas, për të gjitha palët, përfshirë personat e interesuar që e kërkojnë atë.

2. Sekretari/ja e Bordit kryen dokumentin e të gjitha vendimeve dhe materialeve mbështetëse që kanë shërbyer për një vendimmarrje të caktuar nga Bordi.

3. Punonjësi i protokollit ka përgjegjësinë për regjistrimin e të gjitha shkresave dhe materialeve, që dalin nga ERE, në adresë të të tretëve. Të gjitha shkresat apo materialet për brenda dhe jashtë institucionit nënshkruhen nga kryetari i ERE-s dhe, në mungesë të tij, nga personi i ngarkuar prej tij.





## Neni 19

**Fillimi i procedurës**

1. Bordi merr vendim për fillimin ose jo të procedurave të shqyrtimit, për çdo aplikim që ka të bëjë me ushtrimin nga ERE të autoritetit, për:

a) dhënie, ndryshim, rinovim, transferim, heqje licence;

b) certifikim të operatorëve të transmetimit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror;

c) përcaktim të tarifave dhe çmimeve të shitjes së energjisë elektrike dhe të gazit natyror për aktivitetet e rregulluara;

d) kualifikim dhe dhënie të certifikatës së origjinës së prodhimit të energjisë elektrike, nga burime të rinovueshme të energjisë;

e) për kërkesat për përjashtim nga aksesi i palëve të treta të infrastrukturave të reja apo ekzistuese të gazit natyror;

f) miratimin e të gjitha akteve nënligjore të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

2. Vendimi i Bordit për fillimin ose jo të procedurës, si rregull merret jo më vonë se 12 ditë pune, nga regjistrimi i aplikimit për licencim në ERE.

3. Bordi merr vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit nëse konstaton se aplikimi plotëson kryesisht kërkesat sipas rregullorëve përkatëse.

## PJESA V

## PROCEDIMI I APLIKIMEVE

## Neni 20

**Procedimi i aplikimit për marrje licence**

1. Një person që kërkon të licencohet në një apo më shumë nga aktivitetet e parashikuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” apo në aktivitetet e parashikuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, duhet të paraqesë në ERE, një aplikim sipas formatit të kërkuar nga ERE, në rregulloren, “Për procedurat për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”.

2. Pasi Bordi të ketë marrë vendim për fillimin e procedurës së shqyrtimit të një aplikimi për licencë, drejtoria e ngarkuar për shqyrtimin e aplikimit, përgatit njoftimin e aplikimit për licencë.

## Neni 21

**Procedura e aplikimeve për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve**

1. I licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës, jo më vonë se data 1 shtator të vitit aktual, duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin të kërkuar sipas kësaj rregullore dhe metodologjive përkatëse.

Dërgimi me vonesë i të dhënave dhe aplikimit për tarifë përben kundërvajtje administrative në kuptim të nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. Mbas shqyrtimit paraprak dhe në kushtet kur aplikimi i plotëson kryesisht kërkesat e shprehura në pikat, 1-4, të nenit nr. 22, ERE merr vendimin për fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit.

3. Mbas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit drejtoritë teknike/grupi i punës i ngarkuar, përgatisin për të licencuarin/it, njoftimin për vendimin e Bordit.

4. Në çdo kohë gjatë shqyrtimit të një aplikimi për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror, ERE ruan të drejtën për të kërkuar çdo informacion që e konsideron të nevojshëm për vendimmarrjen e saj, në lidhje me aplikimin e paraqitur.

## Neni 22

**Rregulla të përgjithshme për paraqitjen e aplikimeve për përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe/apo të gazit natyror nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e energjisë**

1. Në rastin e aplikimit për përcaktimin /rishikimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe/apo të gazit natyror, aplikimi shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

1.1 Një deklaratë që përshkruan qëllimin dhe efektin e propozimit të paraqitur;

1.2 Efektet e pritshme në të ardhurat e shoqërisë nga tarifata apo çmimet e propozuara;

1.3 Çdo ndryshim në strukturën e tarifave dhe çmimeve, që pritet të rezultojnë nga propozimi i paraqitur;



1.4 Tarifat/çmimet e aplikuara nga aplikuesi ndaj klientëve të tij, për çdo shërbim të energjisë elektrike dhe/apo të gazit natyror, duke përfshirë:

a) tarifën ndaj klientëve për shërbimin që kryhet nga shoqëria, si dhe çdo tarifë shtesë për shërbime të veçanta;

b) çdo tarifë që lidhet me çfarëdo programi të veçantë, përfshirë përshkrimin e programit;

c) çdo pagesë tjetër që aplikohet ndaj klientëve, për të cilën aplikuesit i kërkohet të paraqesë propozimet; dhe

d) çdo informacion tjetër të nevojshëm për të argumentuar ndryshimet në tarifat/çmimet e kërkuara nga aplikuesi.

1.5 Termat dhe kushtet në të cilët do t'u sigurohet shërbimi i energjisë elektrike dhe/apo i gazit natyror klientëve, përfshirë:

a) mundësinë e sigurimit të shërbimit për klasa/grupe të ndryshme klientësh;

b) llojin e shërbimit që siguron, përfshirë çdo informacion teknik të nevojshëm për të diferencuar këto shërbime nga shërbimet e tjera dhe sipas klasave apo grupeve të klientëve;

c) zonat e ndryshme të shërbimit dhe të tarifave/çmimeve përkatëse që shoqëria aplikon apo propozon për t'u aplikuar, nëse ka; dhe

d) çdo informacion shtesë të nevojshëm për të përcaktuar termat dhe kushtet e shërbimit.

3. Propozimet për përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve duhet të përmbajnë një deklaratë të vitit të testimi, që zgjidhet të përdoret nga shoqëria, përfshirë një raport vjetor për vitin e testimi, shpenzimet, të ardhurat dhe tarifat/çmimet e aplikuara gjatë vitit të testimi, si dhe rregullimet e propozuara që lidhen me shpenzimet, të ardhurat dhe tarifat/çmimet për vitin e testimi duke përfshirë deklaratimet, prezantimet ose dokumentet e punës, që justifikojnë çdo rregullim sipas metodologjive të llogaritjes së tarifave dhe çmimeve për shërbimet e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të miratuara nga ERE.

4. Propozimet për përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve duhet të përmbajnë, ku është e aplikueshme, një përshkrim të çdo ndryshimi që lidhet me përbërjen e tarifave dhe çmimeve, duke përfshirë arsyet për këto ndryshime, efektet e ndryshimeve të propozuara ndaj klasave/grupeve të ndryshme të klientëve ndaj shërbimeve të tjera, që sigurohen nga aplikuesi apo shoqëri të tjera, që

ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e energjisë, si dhe ndryshimet në faturat përkatëse çdo klasë/grup të klientëve.

5. Në qoftë se aplikuesi pretendon se ndonjë nga informacionet e kërkuara sipas këtij neni apo metodologjive përkatëse nuk është i mundshëm, ai duhet të paraqesë arsyet e pretendimit. Paaftësia për të dhënë arsye të përshtatshme për mosparaqitjen e ndonjë informacioni shkakton trajtimin e propozimit si një propozim të parregullt.

6. Si rregull, ERE-ja do të shpallë vendimet mbi përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve brenda datës 15 dhjetor të vitit që është paraqitur aplikimi.

7. Mbas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit, i licencuari duhet të njoftojë:

a) Brenda 10 ditëve kalendarike publikun, nëpërmjet botimit jo më pak se në dy/tri gazeta me qarkullim në nivel vendi apo në zonën ku aplikuesi siguron shërbimin, në lidhje me masën e propozuar për ndryshimin e tarifave dhe çmimeve, si dhe përqindjen e ndryshimit të tyre për çdo klasë/grup konsumatorësh, duke shprehur qartë emërtimin e tyre. Në çdo rast, brenda tri ditëve kalendarike nga botimi i njoftimit, i licencuari do të njoftojë ERE-n për kryerjen e botimit në gazetë;

b) Në rastet kur aplikuesi nuk bën publikimin sipas paragrafit të mësipërm, ERE-ja mund të vendosë për penalizimin e aplikuesit dhe bën publikimin e aplikimit sipas kërkesave të paragrafit të mësipërm. Kostot e botimit të këtij njoftimi i transferohen subjektit që ka detyrimin për zbatimin e paragrafit të parë të pikës 7.

8. Si rregull, gjatë shqyrtimit të aplikimit, ERE organizon seanca dëgjimore teknike me aplikuesin, si dhe në çdo rast zhvillon seanca dëgjimore publike sipas rregullave për zhvillimin e seancave dëgjimore.

## PJESA VI

### RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR TRAJTIMIN E ANKESAVE

Neni 23

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Për mosmarrëveshjet midis të licencuarit dhe klientëve të tij, si dhe midis vetë të licencuarëve, çdo ankues duhet të paraqesë në ERE kërkesën duke përdorur formën standarde që i bashkëlidhet këtyre rregullave.



2. Ankuesi në çdo rast, përveç formularit standard, mund të paraqesë në ERE edhe vetëm kërkesën për zgjidhje të mosmarrëveshjes me informacionin si më poshtë:

a) Të përcaktojë qartë palën ose palët që besohet se janë përgjegjëse për çështjen e trajtuar në ankesë;

b) Të përcaktojë qartë veprimin ose mosveprimin, që mendohet se është në kundërshtim me ligjet në fuqi ose kërkesat e rregullimit dhe të shpjegojë pse veprimi ose mosveprimi është i tillë;

c) Të paraqesë një përlllogaritje të ndikimit ose barrës financiare, nëse ka, të krijuar për ankuesin, si dhe të tregojë ndikimet praktike, operative ose ndikime të tjera jofinanciare të shkaktuara, si rezultat i veprimit ose mosveprimit, përfshirë aty ku është e aplikueshme, ndikimet mbi mjedisin, mbi sigurinë ose qëndrueshmërinë e furnizimit;

d) Të përcaktojë veprimin korrigjues, ndihmën apo dëmshpërblimin e kërkuar për padrejtësinë ose dëmin që i është shkaktuar.

3. Ankuesi do të bashkëngjisë të gjitha dokumentet dhe faktet, që posedohen ose që mund të sigurohen prej tij, përfshirë, por jo duke u kufizuar vetëm me kontratat dhe deklaratat zyrtare, të cilat mbështesin ankesën.

4. Për mosmarrëveshjet e klientit me të licencuarin, klienti përpara se të paraqesë një kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në lidhje me një shoqëri furnizimi, klienti duhet të tentojë fillimisht ta zgjidhë mosmarrëveshjen nëpërmjet diskutimit të çështjes me zyrën e ankesave të klientëve të shoqërisë së furnizimit. Për mosmarrëveshjet midis të licencuarve, i licencuari ankues do të tentojë të zgjidhë mosmarrëveshjen me mirëkuptim me të licencuarin në konflikt.

5. Çdo person mund të paraqesë një ankesë ndaj një të licencuari për të kërkuar veprimin e ERE-s, kundër personave që mendohet se janë në kundërvajtje ose dhunim të çdo ligji, rregulli, urdhri apo akteve të tjera ligjore të administruara nga ERE ose për çdo gabim tjetër të menduar, mbi të cilat ERE mund të ketë juridiksion.

6. Ankesa në ERE mund të paraqitet nëpërmjet postës ose dorazi në zyrën e protokollit të ERE-s. Ajo regjistrohet dhe protokollohet në datën që mbërrin në ERE.

7. Ankesat që përmbajnë materiale fyese ose denigruese nuk trajtohen nga ERE, pa paragjykuar

nëse ai ankues mund të ketë paraqitur një ankesë të ligjshme. ERE i bën me dije ankuesit arsyet e mostrajtit të ankesës së tij.

8. ERE do t'i dërgojë brenda 10 (dhjetë) ditëve të rregullta pune nga marrja e një ankese të rregullt, një kopje të saj, palës ose palëve të konsideruara si përgjegjëse për çështjen që trajtohet në të (i ankimuari).

9. I ankimuari do t'i përgjigjet ankesës brenda 15 ditëve pune pas njoftimit të ankesës. I ankimuari do t'i dërgojë një kopje të përgjigjes ERE-s dhe një kopje tjetër ankuesit.

10. Në çdo rast ERE rezervon të drejtën për të zhvilluar seanca dëgjimore publike, si dhe/apo të kryejë kryesisht verifikime apo inspektive.

11. Për mosmarrëveshjet midis të licencuarve apo midis të licencuarit dhe klientit, objekti i të cilave paralelisht lidhet me një vendimmarrje tjetër në proces nga Bordi, atëherë afatet e përcaktuara më sipër apo zhvillimi i mundshëm i seancave dëgjimore do të bëhet në afate të ndryshme nga sa përcaktuar në këtë nen, për të mundësuar trajtimin e ankesës brenda afatit të shqyrtimit të çështjes në procedim nga Bordi që ka lidhje edhe me objektin e ankesës.

12. Për ankesat e përsëritura të paraqitura nga të licencuarit apo klientët, me të njëjtat palë dhe me të njëjtin objekt, njoftohen anëtarët e Bordit për mosmarrëveshjen e riparqitur në ERE. Kryetari zhvillon një mbledhje të Bordit, i cili përcakton më pas natyrën sesi do të procedohet me ankimin apo mosmarrëveshjen. Mbledhjet e Bordit, të parashikuara sipas kësaj pike, do të jenë të karakterit informativ dhe udhëzues për zgjidhjen e çështjes, objekt i mosmarrëveshjes apo ankesës nga personeli teknik i ERE-s. Për ankesat e përsëritura të paraqitura nga klientët ndaj një të licencuari, Bordi mund të vendosë, rast pas rasti, me kërkesë të kryetarit, për zgjidhjen e mëtejshme të ankesës.

13. Në çdo kohë kur e konsideron të nevojshme, kryetari i ERE-s mund të kërkojë trajtimin nga Bordi të një ankese të paraqitur në ERE, brenda autoritetit dhe kompetencës së dhënë nga legjislativi në fuqi.

14. Rregullat specifike të trajtimit të ankesave dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve janë objekt miratimi nga ERE.



Neni 24

**Kërkesat e tjera**

1. Nëse një person paraqet një kërkesë të ndryshme nga sa parashikohet në këto rregulla atëherë ERE do të procedojë në përputhje me dispozitat që rregullojnë atë çështje sipas legjislacionit në fuqi.

2. Çdo person që paraqet një kërkesë në ERE, mund ta dërgojë atë nëpërmjet postës zyrtare apo në rrugë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Një kërkesë duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përmbajë emrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit që paraqet kërkesën dhe një deklaram të shkurtër dhe të thjeshtë të natyrës së argumenteve të tij.

4. Në çdo rast të paraqitjes së kërkesave për shprehje mendimi nga ana e ERE-s, për interpretime të akteve nënligjore të ERE-s, ky mendim do të jetë rezultat i diskutimit dhe qëndrimit të mbajtur në mbledhjen e Bordit.

Neni 25

**Ndërhyrja e detyruar**

1. Mbas paraqitjes së një kërkesë për të ndërhyrë në një procedim të ERE-s, do të lejohen të ndërhyjnë si palë në procedim: a) çdo person që është apo mund të jetë anëtar i një grupi, që është ose mund të jetë i prekur direkt dhe në mënyrë të konsiderueshme nga procedimi; si dhe b) çdo institucion shtetëror.

2. Bordi mund t'i mohojë ndërhyrjen çdo personi që ka paraqitur një kërkesë për ndërhyrje në kohë sipas paragrafit 1 të këtij neni, mbi bazën se personi që paraqet kërkesën nuk ka një interes direkt dhe thelbësor në procedim.

3. Bordi mund të kufizojë pjesëmarrjen e çdo personi që paraqet kërkesë për të ndërhyrë sipas këtij neni, kur ky person gjykohet nga Bordi se ka të drejtë të ndërhyjë vetëm në lidhje me një pjesë të çështjes në procedim.

4. Kur pjesëmarrja e çdo personi është e kufizuar ose e mohuar sipas këtij neni, ERE do të përfshijë në regjistrimet një shënim në lidhje me këtë fakt dhe arsyet e tij.

PJESA VII

**HARTIMI I AKTEVE NËNLIGJORE**

Neni 26

**Rregullat për hartimin, rishikimin e miratimin e akteve nënligjore me statusin rregullorë, udhëzim, metodologji, licencë**

1. Për hartimin apo rishikimin e një akti nënligjor që ka të bëjë me ushtrimin nga ana e ERE-s, të autoritetit në drejtim të miratimit të akteve nënligjore, me iniciativën e vet apo me propozim të subjekteve që kanë të drejtën e hartimit të një akti objekt i miratimit nga ERE, kryetari, në konsultim me anëtarët e Bordit urdhëron, ngritjen e një grupi pune i cili përgatit projektaktin dhe propozon për shqyrtim në Bord.

2. Procedurat e tjera deri në miratimin e aktit të hartuar apo rishikuar me iniciativën e ERE-s apo me propozim të subjekteve që kanë të drejtën e hartimit të një akti do të kryhen vetëm mbas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave nga Bordi.

3. Pas hartimit të draftit apo pas analizës së draftit në rastet e propozimeve nga subjektet që kanë të drejtën e një propozimi në ERE, publikon, për 2 ditë pune, një njoftim në 2 gazeta me qarkullim kombëtar dhe në faqen e saj të internetit, duke ftuar palët e interesuara ose persona të tjerë të njihen me projektaktin dhe të dërgojnë komente me shkrim. ERE do të njoftojë palët e prekura duke siguruar një kopje të projektaktit, për të cilin kanë filluar procedurat me vendim të Bordit.

4. ERE mund të vendosë rast pas rasti për zhvillimin e seancave dëgjimore me qëllim marrjen e mendimit nga palët e tjera për një projektakt.

5. Mbas marrjes së një kërkesë për njohje me procedurat e rishikimit dhe miratimit të aktit nënligjor nga ERE, ERE do t'u sigurojë një kopje të projektaktit çdo palë të prekur ose personi të interesuar.

6. Të gjitha palët e interesuara do të dërgojnë komentet e tyre me shkrim për projektaktin brenda afateve të përcaktuara nga ERE, në njoftimin për subjektin dhe në njoftimin publik në gazetë.

7. ERE do t'u dërgojë kopje të aktit të miratuar të gjitha palëve që kanë shprehur komente apo interes në proces.

8. Në çdo rast, ERE publikon në faqen zyrtare të saj të internetit kopje të aktit të miratuar.



## PJESA VIII SEANCAT DËGJIMORE

Neni 27

### Llojet e seancave dëgjimore

1. Në përputhje me autoritetin e dhënë nga ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazin natyror”, ERE, gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësisë në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror, mund të organizojë seancat dëgjimore si më poshtë vijon:

- seanca teknike;
- seanca zyrtare publike.

2. Kryetari i ERE-s, në konsultim me Bordin, vendos mbi zhvillimin e seancës dëgjimore publike, që do të zhvillohet në përputhje me problematikën dhe çështjen që trajtohet.

Neni 28

### Seancat zyrtare publike

ERE zhvillon seanca zyrtare publike me qëllim marrjen e komenteve nga palët e interesuara lidhur me tarifat dhe çmimet e shitjes së energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Neni 29

### Seancat teknike

ERE zhvillon rast pas rasti seanca teknike me të licencuar, që kanë aplikuar për rishikim tarife, të çmimeve, marrjen, ndryshimin, transferimin, rinovimin apo heqjen e një licence, miratimit të akteve të tjera nga ERE, si dhe në rastet e mosmarrëveshjeve që kanë lindur për zbatimin e një akti apo vendimi të ERE-s, apo gjatë shqyrtimit të marrëveshjeve në tregun e rregulluar, si dhe për çështjet të tjera nën përgjegjësinë e ERE-s.

Neni 30

### Fillimi i seancave të dëgjimit

1. Një seancë dëgjimi fillon mbështetur në urdhrin e kryetarit të ERE-s.

2. Çdo urdhër apo njoftim, sipas pikës 1 të këtij neni, përcakton:

- a) autoritetin dhe juridiksionin nën të cilin mbahet seanca e dëgjimit;
- b) llojin e seancës;
- c) personin drejtues;

d) personat e tjerë të ngarkuar për çështjen objekt i seancës dëgjimore;

e) thirrjen e ekspertëve të jashtëm sipas rastit;

f) datën, orën dhe vendin e seancës së dëgjimit; dhe

g) çdo çështje tjetër të përshtatshme.

3. Personi drejtues do të sigurojë njoftimin e anëtarëve të Bordit për objektin dhe kohën e zhvillimit të seancës dëgjimore. Në përfundim të seancës dëgjimore, personi drejtues dhe personat e tjerë që kanë ndjekur seancën dëgjimore, do të informojnë Bordin mbi seancën dëgjimore të zhvilluar.

Neni 31

### Njoftimet

1. Për seancat dëgjimore teknike, ERE njofton secilën nga palët që ka shprehur interes, si dhe palët e identifikuar të nevojshme për procesin, jo më vonë se 3 ditë pune nga data e planifikuar për zhvillimin e seancës. Njoftimi përmban informacion mbi datën, orën vendin qëllimin e zhvillimit të seancës dëgjimore për çështjen objekt i seancës dëgjimore.

2. Për seancat dëgjimore publike për shqyrtimin e propozimeve nga të licencuarit për tarifat dhe çmimet, ERE njofton palët e identifikuar si të nevojshme për procesin jo më vonë se 7 ditë pune nga data e planifikuar për zhvillimin e seancës. ERE njofton për dy ditë me radhë në dy gazeta me qarkullim kombëtar për zhvillimin e seancës.

3. Palët e interesuara duhet të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në seancën dëgjimore zyrtare publike, të paktën 2 ditë pune para datës së zhvillimit të seancës.

Neni 32

### Procedurat e zhvillimit të seancave dëgjimore

1. Personi drejtues, në fillim të seancës dëgjimore, duhet t’u shpjegojë palëve procedurën dhe rregullat e tjera të zhvillimit të seancës dëgjimore dhe, gjithashtu, prezanton çështjen që do të trajtohet.

2. Të gjitha seancat dëgjimore që do të organizohen nga ERE, regjistrohen dhe u bëhen të ditura palëve në fillim të çdo seance dëgjimore.

3. Dosjet e seancave dëgjimore zyrtare janë të hapura për inspektim publik dhe ruhen sipas rregullave që përcakton legjislacioni në fuqi.



4. Gjatë seancave të dëgjimit, të gjitha palëve të interesuara do t'u jepet mundësia të parashtrijnë opinionin dhe arsyetimet e tyre lidhur me çështjen që diskutohet, si dhe zgjidhjet.

5. Regjistrimet në magnetofon dhe pajisje të tjera mekanike ose elektronike, përveç atyre të përdorura siç duhet nga sekretari/ja, janë të lejueshme në një seancë dëgjimore zyrtare e publike.

Në përfundim të një seance teknike dëgjimi, personi i ngarkuar nga drejtuesi i seancës harton një përmbledhje për çështjet e diskutuara dhe konkluzionet e arritura. Kjo përmbledhje u shpërndahet të gjithë personave në seancë për komente sugjerime dhe aprovim.

Në çdo rast, një kopje e raportit përmbledhës të kësaj seance do t'i dërgohet Bordit të ERE-s.

Neni 33

#### **Rregulla të zhvillimit të seancës dëgjimore**

1. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore personi drejtues do të sigurojë të drejtën e fjalës për secilën nga palët prezente në seancë që e kërkon një gjë të tillë.

2. Për efekt të mbarëvajtjes, kur palët në proces janë shumë dhe për llogari të një pale të caktuar paraqiten më shumë se 2 persona, atëherë ERE do të sigurojë pjesëmarrjen në panelin kryesor të dy personave që caktohen nga vetë pala pjesëmarrëse.

3. Çdo person që merr pjesë ka të drejtë të dëgjojë, të mbajë shënime e të bëjë pyetje sipas radhës së caktuar nga personi drejtues i seancës.

4. Ndalohet ndërprerja e fjalës së folësit, përdorimi i celularëve dhe pirja e duhanit.

5. Nëse ndonjë nga personat pjesëmarrës konsiderohet se prish qetësinë dhe mbarëvajtjen e mbledhjes, me urdhër të personit drejtues vendoset largimi i tij nga seanca.

6. Në fillim u jepet fjala përfaqësuesve të të licencuarit për prezantimin e aplikimit dhe më pas ftohen palët të shprehin komentet dhe pyetjet e ndryshme lidhur me aplikimin.

7. Mbas dëgjimit të përgjigjeve të përfaqësuesve të të licencuarit, personi drejtues deklaron mbylljen e seancës.

8. Nëse seanca kërkon një kohë më të gjatë nga ajo e planifikuar, personi drejtues në këshillim edhe me palët prezente, mund të vendosë vazhdimin e seancës në një ditë tjetër.

9. Nëse një seancë dëgjimore nuk arrin të ezaurojë të gjitha çështjet e planifikuara, ajo mundet të vazhdojë në një datë tjetër e cila do të komunikohet nga ERE në përfundimin e seancës në fjalë ose nëpërmjet një komunikimi tjetër, i cili duhet t'u bëhet palëve të interesuara jo më vonë se një ditë kalendarike përpara organizimit të vijimit të seancës.

Neni 34

#### **Dokumentacioni**

Palët, gjatë seancës dëgjimore mund të paraqesin komente me shkrim, të cilat janë pjesë e dosjes së seancës dëgjimore dhe janë objekt i aksesit të publikut në dokumentet e ERE-s.

Neni 35

#### **Transkriptimet**

1. Çdo deklaratë e bërë në një seancë dëgjimi transkriptohet (zbardhet) në një raport të saktë, pa hequr asgjë, përveç kur në kushte të kufizuara, personi drejtues mund të urdhërojë me shkrim heqjen nga regjistrimet të deklaratave fyese.

2. Pas mbylljes së një regjistrimi, ndryshimet në transkriptim nuk lejohen, përveç rasteve të parashikuara nga piken 3 të këtij neni.

3. Çdo korigjim në transkriptimin e një seance dëgjimi mund të bëhet, vetëm nëse personi drejtues vendos se korigjimi përputhet me transkriptin e provës së paraqitur në seancën dëgjimore.

Neni 36

#### **Raportimi**

1. Në rastin e seancave dëgjimore zyrtare e publike, personi drejtues dhe personat e ngarkuar për çështjen objekt të seancës dëgjimore, përgatitin raportin mbi seancën dëgjimore, i cili është pjesë e relacionit përfundimtar që përgatitet për Bordin.

PJESA IX

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 37

#### **Përsheptimi i afateve dhe ndryshimi i kërkesave procedurale**

Për kërkesat e paraqitura në ERE për përsheptim të një procesi, objekt i vendimmarrjes së Bordit, për aq sa lejohet nga ligji, aty ku ka një shkak të arsyeshëm, Bordi do të lejojë personelin teknik të trajtojë një çështje me procedurë të



përsheptuar apo me një procedurë të ndryshme nga kërkesat procedurale të përcaktuara në rregullat e veçanta, kur i sheh ato të papraktikueshme, të papërshtatshme ose të panevojshme, me kusht që ky proces të mos kufizojë të drejtat e palës, subjekt i procedurës të trajtuar nga Bordi.

Neni 38

### **Konflikti me funksionet ligjore ose institucionale**

Këto rregulla janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, autoritetin dhe funksionet ligjore të ERE-s. Në rast konflikti mes legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me autoritetin dhe kompetencat e ERE-s dhe këtyre rregullave, do të prevalojë legjislacioni në fuqi.

Neni 39

### **Rishikimi dhe ndryshimi i rregullave**

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit.

Neni 40

### **Hyrja në fuqi**

Këto rregulla hyjnë në fuqi menjëherë dhe publikohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

## **VENDIM**

**Nr. 97, datë 17.6.2016**

### **MBI MIRATIMIN E LICENCËS SË TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.6.2016, mbasi shqyrtoi draftlicencën dhe relacionin e përgatitur nga grupi i punës, për miratimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike,

#### **VENDOSI:**

1. Të miratojë licencën për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (bashkëlidhur).

2. Efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me

miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

Republika e Shqipërisë  
Enti Rregullator i Energjisë

### **LICENCË PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Seria: \_\_\_\_\_

Numri i licencës: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi: \_\_\_\_\_

(Vendimi i ERE-s nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_)

Licenca i jepet: \_\_\_\_\_

(Emri dhe adresa )

Kodi fiskal: \_\_\_\_\_

Certifikata e regjistrimit: \_\_\_\_\_

(Seria, numri, vendi i regjistrimit)

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në pjesën e pestë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep këtë licencë prodhimi (licenca), për të kryer aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (PEE), personit të lartpërmendur, i quajtur “i licencuari”, subjekt i kushteve të kësaj licence, si dhe kushteve të përcaktuara në vendimin Bordit të ERE-s. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej \_\_, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE-ja në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.

[Kryetari]

[Vula e ERE-s]



Republika e Shqipërisë  
Enti Rregullator i Energjisë

KUSHTET E LICENCËS  
PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE

Seria: \_\_\_\_\_ Nr. i licencës \_\_\_\_\_

I jepet: \_\_\_\_\_

(Emri i plotë i të licencuarit)

**Dispozita të përgjithshme**

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas pjesës së pestë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, që lëshon dhe deklaron hyrjen në fuqi të kësaj licence.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj licence pushon së qeni efektiv, ai kusht do të hiqet nga kushtet e licencës dhe kushtet e mbetura do të vazhdojnë të jenë në fuqi.

1.3 Kjo licencë nuk do t’i transferohet tërësisht ose pjesërisht, asnjë personi tjetër pa miratimin paraprak me shkrim të ERE-s. Kur miraton një transferim, ERE mund ta modifikojë periudhën e licencës ose kushtet e tjera të licencës pasi të ketë treguar një arsye të bazuar.

1.4 ERE ndryshon licencën në përputhje me nenin 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, në rastet e mëposhtme:

- a) me iniciativë të ERE-s;
- b) në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
- c) kur ndryshojnë kushtet e kontratës koncesi-onare;
- d) me kërkesën e të licencuarit.

1.5 I licencuari mund të kërkojë një modifikim të kësaj licence nëpërmjet një kërkesë të detajuar me shkrim që duhet të përmbajë një justifikim për modifikimin e kërkuar. Në çdo rast ERE do të kryejë një procedurë modifikimi sipas nenit 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

1.6 I licencuari mund t’i parashtojë ERE-s një kërkesë me shkrim për rinovimin e licencës jo më pak se 2 muaj para përfundimit të afatit të licencës së dhënë. Afati i licencës mund të zgjatet kur Bordi, bazuar në ligjin nr. 43 /2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rregulloren për procedurat e licencimit dhe në prova të besueshme, konkludon se:

- a) I licencuari i ka përmbushur kushtet e licencës dhe u është përmbajtur kërkesave të të

gjithë legjislacionit në fuqi gjatë afatit të licencës.

1.7 Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në licencë, në kushtet e licencës dhe në shtojca, do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

“**Shërbimet ndihmëse**” janë shërbimet e nevojshme për operimin e qëndrueshëm të sistemit të transmetimit ose **shpërndarjes**;

“**Biznesi shoqërues**”, çdo biznes që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht:

- 1) zotërohet nga i licencuari; ose
- 2) zotëron të licencuarin; ose
- 3) zotërohet nga një person që zotërohet nga i licencuari.

“**Ndersubvencionet**”, transferimi i fondeve ose alokimi i kostove brenda llogarive të të licencuarit ose mes bizneseve shoqëruese për mbështetje financiare të një veprimtarie ose biznesi me shpenzimet e një tjetri.

“**Energjia elektrike**”, energjia elektrike dhe kapaciteti elektrik, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe.

“**Tregtar**” është çdo person juridik, i cili kryen veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

“**Klient**” është një konsumator shumice ose fundor i energjisë elektrike.

“**ERE**” është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për sektorin e gazit natyror.

“**Legjislacioni në fuqi**”, ligjet e Republikës së Shqipërisë, të shpallura nga Kuvendi Shqiptar dhe që janë në fuqi gjatë periudhës së kësaj licence dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga ERE apo organet e tjera të ngarkuara me ligj.

“**I licencuari**”, personi që mban këtë licencë për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike që përmendet në faqen e parë të kësaj licence.

“**Veprimtaria e licencuar**”, veprimtari e nevojshme me qëllim tregtimin e energjisë elektrike në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

“**Marrëveshje të shitblerjes së energjisë elektrike**”, kontratë e nënshkruar për shitblerjen e energjisë elektrike, e lidhur midis një të licencuarit dhe një subjekti tjetër sipas përcaktimeve të rregullave të tregut.

“**Personi**”, person do të thotë çdo person juridik.

“**Tarifa e rregulluar**”, një tarifë e aprovuar nga ERE sipas legjislacionit në fuqi.





“Rregulloret dhe rregullat”, standardet, kodet, rregulloret, urdhrat dhe rekomandime të tjera ligjërish në fuqi të miratuara nga ERE.

“Transferimi” do të thotë çdo shitje, dhënie me qira ose ndonjë transaksion tjetër, tërësisht ose pjesërisht, i së drejtës për t’u angazhuar në veprimtarinë e licencuar.

“Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)” është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkonjeksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

“Sistemi elektroenergjetik” është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centralet elektrike, linjat elektrike, nënstationet dhe pajisjet e transmetimit e shpërndarjes, me qëllim transmetimin apo shpërndarjen e energjisë elektrike te klientët.

“Tregtimi”, lëvizja e fluksit të energjisë elektrike nga impiante ose instalime elektrike të një subjekti, në impiante ose instalime elektrike të një subjekti tjetër, në përputhje me marrëveshjet e lidhura nga i licencuari për shitblerjen dhe transmetimin e energjisë elektrike me qëllim shitjen të të licencuarit e tjerë.

“Veprimtaria dispeçerues”, operimi i sistemit elektroenergjetik, duke marrë parasysh programimin dhe ruajtjen e sigurisë operative dhe parametrave të cilësisë sipas kushteve teknike.

## 2. Kryerja e veprimtarisë së licencuar

2.1 I licencuari autorizohet nga kjo licencë për kryerjen e veprimtarisë së licencuar.

2.2 I licencuari nuk do të bashkëpunojë në asnjë mënyrë me të licencuar të tjerë lidhur me veprimtarinë e licencuar në dëm të tregtuesve, furnizuesve ose klientëve dhe përdoruesve ekzistues ose të mundshëm.

2.3 I licencuari nuk do të angazhohet në kryerjen e veprimeve ose në ndonjë aktivitet tjetër që përbën sjellje antikonkurrese, sipas legjislacionit në fuqi.

2.4 I licencuari do ta kryejë veprimtarinë e licencuar në përputhje me parimet e eficiencës ekonomike dhe objektivin e arritjes së kostos më të ulët me standarde të përcaktuara të cilësisë dhe të performancës.

2.5 I licencuari nuk do të angazhohet në veprimtari të tjera, që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen si duhet të veprimtarisë së

licencuar. I licencuari do të njoftojë ERE-n para se të ndërmarrë ndonjë veprimtari, përveç veprimtarisë së licencuar. ERE-ja mund ta ndalojë të licencuarin të kryejë ndonjë veprimtari, përveç veprimtarisë së licencuar ose mund të vendosë kushte për kryerjen e kësaj veprimtarie, që janë të nevojshme për mbrojtjen e klientëve.

2.6 I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të përpiqet të parandalojë të licencuar të tjerë apo konkurrues potenciale që të angazhohen ligjërish ose të hyjnë në biznesin e energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë.

2.7 Gjithë marrëveshjet e shitblerjes së energjisë elektrike duhet të përputhen me legjislacionin në fuqi për aq sa kërkohet nga këto të fundit.

2.8 Të gjitha marrëveshjet do të jenë objekt monitorimi nga ERE për të siguruar funksionimin siç duhet të tregut dhe se të licencuarit nuk ushtrojnë ndikim mbi tregun, duke ndjekur praktika të padrejta dhe që bien ndesh me legjislacionin për konkurrencën.

## 3. Detyrimet e të licencuarit

3.1 I licencuari do të respektojë legjislacionin në fuqi gjatë ushtrimit të funksioneve sipas kësaj licence.

3.2 I licencuari do të ndërmarrë masat e nevojshme për garantimin e aftësive teknike dhe financiare për kryerjen e aktivitetit të licencuar.

3.3 I licencuari do të regjistrohet si pjesëmarrës i tregut shqiptar të energjisë elektrike pranë OST/OT, sipas procedurave të regjistrimit dhe do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe vendimet e ERE-s.

3.4 I licencuari do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e eficiencës operative dhe ekonomike të veprimtarisë së licencuar, me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara prej tij në përfitim të klientëve dhe të sektorit të energjisë elektrike.

3.5 I licencuari do të përmbushë gjithë rregullat e operatorit të sistemit të transmetimit të miratuara nga ERE, përfshirë zbatimin e gjithë urdhrave operativë, udhëzimeve, si dhe paraqitjen e informacionit teknik dhe gjithë dokumentacionit tjetër sipas kërkesave të Kodit të Rrjetit dhe Rregullave të Tregut.

### 3.6 Llogaritë dhe raportimi

3.6.1 I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatitë bilance financiare konform legjislacionit në fuqi dhe standardet ndërkombëtare



të kontabilitetit. I licencuari do t'i dorëzojë ERE-s bilancet financiare vjetore, së bashku me raportet e auditit, brenda datës 30 qershor të çdo viti.

3.6.2 Të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe t'i paraqesë ERE-s, më 31 janar të çdo viti, një raport vjetor lidhur me operimet e tij gjatë vitit të mëparshëm kalendarik që përmban sa më poshtë:

a) një përmbledhje dhe analizë të operimit në veprimtarinë e licencuar;

b) sasinë e energjisë së tregtuar, si dhe çmimin e blerjes dhe shitjes së energjisë;

c) çdo ndërprerje të veprimtarisë, si dhe përshkrim i arsyeve të ndërprerjes;

d) një përmbledhje dhe analizë të kontratave të lidhura për shitblerjen e energjisë elektrike në fuqi dhe gjatë vitit që raportohet.

3.6.3 I licencuari do t'i paraqesë ERE-s, me kërkesën e saj dhe sipas formës dhe brenda kohës së vendosur nga ERE, çdo informacion që është i domosdoshëm për ERE-n për të kryer përgjegjësitë e saj rregullatore të autorizuar.

3.6.4 I licencuari do ta njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve, për çdo ndryshim të:

a) adresës;

b) statutit të të licencuarit;

c) certifikatës së regjistrimit;

d) Kodit fiskal;

e) drejtuesve të lartë; ose

3.6.5 Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, deklaratat ose korrespondenca tjetër me ERE-n lidhur me detyrimet sipas kësaj licence duhet të jenë me shkrim, duke caktuar respektivisht nga një zyrtar të autorizuar ose përfaqësues tjetër të të licencuarit ose të ERE-s. Këto dërgohen me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e Palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit. Do të konsiderohen të pranuar edhe gjithë njoftimet e dërguara përmes postës elektronike zyrtare të komunikuar më parë nga palët.

3.7 Përdorimi i informacionit

3.7.1 Sipas ligjit të energjisë elektrike, kodit të transmetimit, kodit të shpërndarjes, rregullave të tregut dhe kërkesave të rregulloreve përkatëse, i licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë nga të tjerët, si rezultat i veprimtarisë së tij

të licencuar nuk do t'i jepet askujt, përveç:

a) me pëlqimin paraprak me shkrim të personit me çështjet e të cilit lidhet informacioni;

b) kur informacioni është tashmë i njohur për publikun;

c) kur të licencuarit i kërkohet ose i lejohet ta përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence, çdo urdhër të ERE-s dhe legjislacionit në fuqi.

3.7.2 Me kërkesën e ERE-s, i licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta mbrojtur informacionin konfidencial që posedon dhe do t'i paraqesë ERE-s raporte që lidhen me respektimin e detyrimeve të parashikuara në paragrafët 3.9.1 dhe 3.9.2.

3.7.3 Informacioni që i sigurohet ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik përveç, kur me kërkesë të veçantë të të licencuarit, ERE me vendim siguron se ky informacion është i natyrës pasurore dhe se interesi publik të cilit i shërbehet nga përhapja e tij nuk do ta justifikojë ose kompensojë dëmin komercial potencial ndaj të licencuarit.

3.8 Pagesat e rregullimit

3.8.1 I licencuari do të paguajë pagesën e rregullimit në mënyrën e përcaktuar nga ERE gjatë afatit të kësaj licence, në përputhje me nenin 17, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

3.8.2 Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit në përputhje me paragrafin 3.8.1, brenda afatit të kërkuar nga ERE-ja, i licencuari do të penalizohet në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

#### 4. Kontrolli mbi performancën e veprimtarisë së licencuar

4.1 ERE do të monitorojë respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës, do të rishikojë raportet e marra nga i licencuari dhe është e autorizuar që të inspektojë në çdo kohë regjistrat financiarë të të licencuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose financiar të veprimtarive të të licencuarit.

4.2 Përfaqësuesit e autorizuar të ERE-s mund të hyjnë në ambientet, pajisjet dhe dokumentet e të licencuarit për të inspektuar veprimtarinë e licencuar sipas rregullave të ERE-s. I licencuari do të japë çdo ndihme të kërkuar nga ERE gjatë këtij inspektimi.



4.3 Në bazë të ankesës së konfirmuar të çdo pale të tretë ose me vetë iniciativën e vet, ERE mund të nisë një hetim për respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës ose rregullave të ERE-s.

4.4 Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i licencuari nuk i ka respektuar kushtet e licencës, ERE duhet të ndërmarrë masa të tjera brenda autoritetit të saj, me qëllim që të sigurojë përmbushjen e afateve dhe kushteve të kësaj licence.

4.5 I licencuari do ta informojë dhe sqarojë ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës, jo më vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.

4.6 I licencuari do t'u bindet vendimeve të nxjerra nga ERE, përfshirë pagesat e gjobave të vëna nga ERE, sipas legjislacionit në fuqi.

## 5. Heqja e licencës

5.1 ERE heq një licencë kur i licencuari:

- a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë;
- b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
- c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;
- ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE;
- d) bëhet financiarisht i paaftë ose kërkon shpalljen e falimentimit;
- dh) me kërkesë të të licencuarit;
- e) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës.

5.2 Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksionari kryesor/ortaku që kontrollon interesat e të licencuarit ndryshohet pa autorizim nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re sipas procedurës së ERE-s për dhënie licence.

5.3 Kjo licencë mund të transferohet vetëm me vendim me shkrim të ERE-s dhe sipas afateve dhe kushteve të vendosura nga ERE. Çdo vendim i ERE-s për ndonjë transferim të kësaj licence do të jetë subjekt i gjyqimit të ERE-s nëse personi të cilit i transferohet licenca do të ketë aftësinë teknike dhe financiare për të plotësuar afatet dhe kushtet e kësaj licence.

5.4 Çdo transferim i kësaj licence pa miratimin e ERE-s do të anulohet dhe do të përbëjë një shkelje të kësaj licence.

5.5 Kur licenca përfundon si pasojë e shkeljeve nga i licencuari të kushteve të licencës, i licencuari do të përgjigjet për koston e që i shkakton ERE-s dhe pjesëmarrësve të tregut si rezultat i këtij përfundimi, siç përcaktohet nga ERE, përfshirë kostot lidhur me transferimin e rregullt të licencës te një i licencuar i ri.

5.6 Kur ERE përcakton se i licencuari ka shkelur një ose më shumë kushte të licencës, të licencuarit do t'i jepet një mundësi e arsyeshme për ta korrigjuar shkeljen para përfundimit të licencës, përveç kur shkelja përfshin korrupsion ose pandershmeri të vërtetuara nga organet me autoritetin përkatës sipas ligjeve në fuqi.

## 6. Situatat e emergjencës

6.1 I licencuari nuk do të konsiderohet se ka shkelur kushtet e kësaj licence në rast se parandalohet në përmbushjen e tyre nga forca madhore ose rrethana të tjera emergjence.

6.2 Në kushtet e emergjencës, i licencuari:

- a) do të sigurojë bashkëpunimin e nevojshëm me autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për të vepruar në situatë emergjence, me qëllim që të rifillojë veprimtarinë brenda një periudhe kohore sa më të shkurtër;
- b) do të plotësojë detyrimet e tij për reduktimin e rreziqeve dhe humbjeve lidhur me jetën, shëndetin dhe pronën e palëve të treta;

c) brenda 24 orëve nga ngjarja e emergjencës, i licencuari do të njoftojë ERE-n për situatën e emergjencës dhe veprimet që do të ndërmarrë për rifilluar veprimtarinë normale.

6.3 Nëse i licencuari e parashikon situatën e emergjencës, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 24 orëve dhe ky njoftim do të përshkruajë se çfarë hapash do të marrë i licencuari për të menjnuar ose përmirësuar ndikimet e situatës emergjente të parashikuara.

## 7. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta për apel

7.1 Çdo çështje e diskutueshme ose pretendim mes të licencuarit dhe çdo pjesëmarrësi në treg lidhur me kushtet e licencës dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.



7.2 Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim midis palëve, në bazë të kërkesës së një prej palëve në mosmarrëveshje, ERE do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7.3 Çdo palë në konflikt mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në Gjykatën e Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

7.4 “Subjektet e licencuara do të zbatojnë vendimet e ERE-s, deri në një vendim gjykatë të formës së prerë”.

Republika e Shqipërisë  
Enti Rregullator i Energjisë

LICENCË  
PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE BRENDË DHE  
JASHTË VENDIT

Licenca i jepet: \_\_\_\_\_  
(Emri i plotë i të licencuarit)  
Seria: \_\_\_\_\_ Nr. i licencës: \_\_\_\_\_  
Data e hyrjes në fuqi të kësaj shtojce: \_\_\_\_\_

**VENDIM**  
**Nr. 98, datë 17.6.2016**

**MBI MIRATIMIN E LICENCËS PËR  
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.6.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës dhe relacionin përkatës, për miratimin e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Të miratojë licencën “Për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike” (bashkëlidhur).

2. Efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara nga ERE në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar dhe furnizuesit publik me pakicë, shtrihen për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale.

Faqe | 10348

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**

Republika e Shqipërisë  
Enti Rregullator i Energjisë

LICENCË  
PËR VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE

Numri i licencës:

Certifikata e regjistrimit:

Seria:

Data e hyrjes në fuqi:

Licenca i jepet:

Shoqëria:

NUIS:

Detyrimi për shërbimin publik: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi:

Kohëzgjatja:

Furnizues i mundësisë së fundit: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi:

Kohëzgjatja:

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në seksionin e dytë të pjesës së pestë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep këtë licencë (licenca), për të kryer veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (FEE) dhe/ose të furnizuesit të mundësisë së fundit ose/dhe për të përmbushur detyrimin e shërbimit publikë/universal, personit të lartpërmendur, i quajtur “i licencuari”, subjekt i kushteve të licencës të bashkëngjitura dhe pjesë integrale të saj, si dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s.

Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi, deri në përfundim të afatit të dhënë në rast se nuk hiqet nga ERE në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu apo sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2015.

KRYETARI I ERE-s



Republika e Shqipërisë  
Enti Rregullator i Energjisë

**KUSHTET E LICENCËS  
PËR VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Seria: \_\_\_\_\_

Numri i licencës: \_\_\_\_\_

I jepet: \_\_\_\_\_

(Emri i plotë i të licencuarit)

**1. Dispozita të përgjithshme**

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur në seksionin II të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, për të lëshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj licence.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj licence bëhet nul ose i anulueshëm apo pushon së qeni në fuqi, ky kusht do të hiqet nga licenca dhe kushtet e mbetura të licencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

1.3 Asetet nuk mund të transferohen tek asnjë person tjetër pa aprovimin paraprak me shkrim të ERE-s. Përrjashtëm nga detyrimi për marrjen e miratimit të ERE-s për transferimin e aseteve, bëjnë rastet e parashikuara në rregulloren “Për transferimin e aseteve”. Kur aprovon një transferim, ERE mund ta ndryshojë kohëzgjatjen e licencës ose kushtet e tjera të saj.

1.4 ERE ka të drejtën ekskluzive për të modifikuar këtë licencë, në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar, si dhe për të përmbushur dispozitat e rregullave të tregut, Kodit të Rrjeti, Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Matjes apo akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE sipas legjislacionit në fuqi.

1.5 Në këtë licencë, përfshirë kushtet e licencës dhe anekset e saj, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përdorur do të kenë kuptimet sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si vijon:

**“Operator i rrjetit”** është operatori i sistemit të transmetimit dhe/ose operatori i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

**“Person”** është një person juridik.

**“Shërbimi i balancimit”** është sigurimi i kapacitetit rezervë i kontraktuar dhe/ose energjia elektrike balancuese, e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin.

**“Biznesi shoqërues”**, çdo biznes që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht:

- a) është pronë e të licencuarit; ose
- b) ka të licencuarin në pronësi; ose
- c) është në pronësi të personit, i cili është pronë e të licencuarit.

**“Ndërsubvencionimet”**, transferim fondesh ose ndarje kostosh brenda llogarive të të licencuarit ose mes bizneseve shoqëruese për mbështetje financiare të një aktiviteti ose biznesi me koston e një tjetri.

**2. Kryerja e aktivitetit të licencuar**

2.1 I licencuari autorizohet nga kjo licencë për të zhvilluar aktivitetin furnizuesit të energjisë elektrike sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2.2 I licencuari nuk do të vendosë për klientët e tij pagesa të ndryshme nga ato të aprovuara nga ERE sipas legjislacionit në fuqi.

2.3 I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të tentojë të parandalojë të licencuarit e tjerë ose pjesëmarrësit potencialë ose konkurrentët që të angazhohen ose të hyjnë në biznesin e furnizimit apo në aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë.

2.4 I licencuari nuk do të përfshihet në ndërsubvencionime. Nëse i licencuari është një kompani vertikalisht e integruar elektroenergjitike, do t'i ndajë llogaritë e tij financiare sipas aktivitetet të prodhimit dhe shpërndarjes brenda afatit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi për të mundësuar që ERE të kolaudojë se nuk ka ndërsubvencionime, aktivitete antikonkurrencë ose diskriminim.

2.5 I licencuari nuk do të përfshihet në asnjë formë aktiviteti monopol ose antikonkurrencë të ndaluar nga legjislacioni në fuqi ose rregulloret dhe rregullat e miratuara nga ERE dhe Autoriteti i Konkurrencës.

2.6 Brenda datës 31 janar të çdo viti, i licencuari do t'i dërgojë ERE-s një informacion dhe deklaratë me shkrim për kryerjen e aktivitetit gjatë vitit paraardhës dhe përmbushjes së kuadrit ligjor në sektorin e energjisë elektrike.

2.7 I licencuari nuk do të bashkëpunojë me persona të tjerë për të dëmtuar interesat e të licencuarve ose klientëve të energjisë elektrike.

2.8 I licencuari do ta kryejë aktivitetin e licencuar në përputhje me parimet e transparencës, të përcaktuara legjislacioni në fuqi.



2.9 I licencuari që do të angazhohet në aktivitete të tjera të ndryshme nga aktiviteti për të cilin është licencuar duhet të informojë ERE-n në rastet kur synon, të:

a) angazhohet në aktivitete tjetër përveç aktivitetit të licencuar; ose

b) të ngrejë një biznes shoqëruar.

2.10 ERE mund ta ndalojë angazhimin në një aktivitet tjetër ose të vendosë kushte të veçanta për ngritjen e bizneseve shoqëruar të nevojshëm për të mbrojtur interesat e konsumatorëve. Në rast se i licencuari nuk përmbush kërkesat e përcaktuara nga ERE, ndaj tij mund të merren masa administrative sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, përfshirë heqjen e licencës.

2.11 I licencuari është i autorizuar të vendosë pagesa të aprovuara nga ERE.

2.12 I licencuari nuk është përgjegjës për mospërmbushjen e kushteve të licencës në rast të një force madhore deri në atë shkallë sa forca madhore është shkaku për këtë mospërmbushje të kushteve të licencës. Në këtë rast, i licencuari duhet të njoftojë menjëherë ERE-n dhe të licencuarit e tjerë ose konsumatorët me të cilët i licencuari ka lidhur marrëveshje.

### 3. Detyrimet e të licencuarit

3.1 I licencuari është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe gjithë vendimet e qeverisë dhe rregulloret e rregullat e miratuara nga ERE.

Furnizuesi, në zbatim të kësaj licence, ka detyrimin të furnizojë klientët me energji elektrike, në përputhje me kontratën e nënshkruar, në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase.

3.2 Furnizuesi është përgjegjës përballë operatorit të sistemit të transmetimit për çdo disbalancë të shkaktuar. Përveç rasteve kur Këshilli i Ministrave ka vendosur për përjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat, klientët fundorë janë përgjegjës përballë furnizuesit për disbalancat e shkaktuara, sipas akteve nënligjore të miratuara nga ERE për rregullat e balancimit.

3.3 Furnizuesi, përveç detyrimeve të përgjithshme, të përcaktuara në kontratë dhe në kushtet e përgjithshme për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik, të siguruar nga pjesëtari i tregut i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, informon klientët e tij, për:

a) të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi kanë ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të energjisë elektrike;

b) konsumin dhe kostot aktuale të energjisë elektrike, me qëllim mundësimin e menaxhimit të konsumit të energjisë nga ana e klientëve;

c) mënyrat e ndryshme të pagesës, të cilat nuk duhet të jenë diskriminuese midis klientëve. Sistemet e parapagimit, nëse do të aplikohen, duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë konsumin e pritshëm;

ç) mundësinë e përdorimit të procedurave të thjeshta për ndjekjen e ankesave të tyre;

d) ndryshimin e kushteve të kontratës, të paktën 15 ditë përpara zbatimit të tyre, duke përfshirë informacionin në lidhje me të drejtën e klientëve për të zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit, me dhënien e njoftimit;

dh) të dhënat e konsumit të tij, duke i mundësuar çdo klienti akses në leximin e aparatit të matjes dhe ndaj të dhënave të matjes, në bazë të një marrëveshjeje të qartë dhe pa pagesë;

e) të drejtat e tyre, në përputhje me udhëzuesin e miratuar nga komuniteti i energjisë.

3.4 Furnizuesit, nëpërmjet faturës së konsumit të energjisë elektrike dhe/apo materialeve promovuese, informon në mënyrë të qartë klientët, për:

a) konsumin faktik të energjisë elektrike;

b) të dhëna për çdo burim energjie të siguruar nga furnizuesi gjatë vitit të mëparshëm;

c) elementet përbërëse të çmimit dhe kostot përkatëse;

ç) të dhënat për ndikimin në mjedis të gazit karbonik dhe mbeturinave radioaktive të emetuara gjatë prodhimit të energjisë elektrike, të siguruar nga furnizuesi në vitin e mëparshëm.

3.5. I licencuari i ngarkuar sipas ligjit me detyrimin për shërbimin universal do të sigurojë furnizimin me energji elektrike me çmime të rregulluara nga ERE vetëm për klientët fundorë që furnizohen sipas shërbimit universal të furnizimit, sipas parashikimit të nenit 83, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

3.6 I licencuari i caktuar sipas ligjit si furnizuesi i mundësisë së fundit është i detyruar të furnizojë klientët, të cilët mbeten pa furnizues, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim, kur:



a) furnizuesi i mëparshëm është në kushtet e paaftësisë paguese ose është në proces falimentimi;

b) furnizuesit të mëparshëm i është hequr ose i është pezulluar përkohësisht licenca;

c) klienti nuk ka arritur të gjejë një furnizues në treg.

3.7 Çmimi me të cilin furnizuesi i mundësisë së fundit furnizon me energji elektrike, përcaktohet nga ERE sipas metodologjisë së miratuar prej saj, në përputhje me përcaktimet e neneve 21 dhe 79, pika 4 e ligjit.

3.8 Të klientit fundor dhe pa kosto shtesë për të. Furnizuesi aktual është i detyruar të furnizojë klientin fundor deri në ndryshimin e furnizuesit.

#### 4. Llogaritë dhe raportimi

4.1 I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë bilance financiare, të cilat do të mbahen të ndara për aktivitetin e licencuar dhe çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të licencuara) ku është angazhuar i licencuari, në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe procedurat e miratuara nga ERE dhe në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i licencuari do t’i dorëzojë ERE-s bilance financiare vjetore deri në datën 31 mars të çdo viti.

4.2 Nëse i licencuari parashikon një situatë emergjence, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë pa vonesë ERE-n dhe ky njoftim do të përshkruajë çfarë masash do të marrë i licencuari për të parandaluar ose përmirësuar ndikimet e situatës emergjente të parashikuara.

4.3 I licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes aktivitetit të tij të licencuar dhe tipave të tjerë të aktiviteteve, në përputhje me rregulloret dhe rregullat e ERE-s. I licencuari do t’i paraqesë ERE-s, me kërkesën e tij, në formën dhe në afatin e vendosur nga ERE, dokumentacionin që vendos bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta mes aktiviteteve që do të ushtrohen, si dhe rezultatet e arritura pas kësaj ndarje.

4.4 I licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të:

- a) adresës;
- b) statutit të licencuarit;
- c) certifikatës së regjistrimit;
- d) kodit fiskal;
- e) organet kryesore drejtuese; ose

Nëse i licencuari nuk e bën këtë njoftim, ERE mund të vendosë gjoba në përputhje me ligjin nr.

43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe rregulloren “Për vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtësimit prej tyre”.

4.5 Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, pretendimet ose korrespondenca tjetër me ERE-n, lidhur me licencën, duhet të jetë me shkrim dhe të nënshkruara respektivisht nga një zyrtar i autorizuar ose përfaqësues ligjor i caktuar i të licencuarit ose ERE-s dhe të dërgohet me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e Palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit.

4.6 I licencuari do të dërgojë në ERE informacion periodik lidhur me:

- i) shpenzimet dhe të ardhurat operative (mujore dhe në progresion 3-mujor);
- ii) pasqyra *Cash-Flow* (mujore dhe progresive);
- iii) tabela e energjisë elektrike të furnizuar (mujore dhe progresive);
- iv) çdo informacion të kërkuar rast pas rasti nga ERE;
- v) numrin e klientëve të furnizuar (mujore dhe progresive);
- vi) grafikët e ngarkesës;
- vii) sistemet e matjes;
- viii) të dhëna mbi ankesat e regjistruara, trajtimit dhe korrektimeve në faturimet përkatëse objekt ankimi (mujore dhe progresive).

#### 5. Përdorimi i informacionit

5.1 I licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë si rezultat i aktivitetit të tij të licencuar nuk do t’i jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:

- a) jepet pëlqim paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni;
- b) informacioni është bërë publik;
- c) kur të licencuarit i kërkohet ose lejohet të përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence sipas një urdhri të ERE-s ose çdo dispozitë ligjore të aplikueshme;
- d) informacioni duhet përhapur në funksion të kryerjes së aktivitetit të licencuar.

5.1.1 I licencuari do të sigurojë që çdo biznes shoqëruar nuk do të përdorë asnjë informacion të të licencuarit për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar dhe do të sigurojë që nuk do të



përhapë asnjë informacion të ndonjë person tjetër (përfshirë biznese të tjera shoqërues), që mund ta mundësojnë këtë person të fitojë çdo lloj përfitimi komercial të pajustificuar.

5.2 I licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta ruajtur konfidencial informacionin në posedim të tij dhe për t'i raportuar ERE-s në përputhje me detyrimet ligjore.

5.2.1 Informacioni i dërguar ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të licencuarit, ERE, me vendim përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe përhapja e tij nuk i shërben interesit publik.

5.2.2 I licencuari nuk do të hyjë në marrëveshje, të cilat i licencuari e di ose duhet ta dijë që çojnë në shkelje të kushteve të licencës.

5.2.3 I licencuari do të respektojë ligjet dhe vendimet e qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe rregulloret e rregullat e ERE-s.

## 6. Pagesat e rregullimit

6.1 I licencuari do t'i paguajë ERE-s pagesa rregullimi në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj licence, siç përcaktohet nga ERE në rregulloren “Për pagesat e rregullimit”, siç është përcaktuar në nenin 17, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

6.2 Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit, brenda afatit të përcaktuar nga ERE, i licencuari do të penalizohet në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

## 7. Kontrolli mbi kryerjen e aktivitetit të licencuar

7.1 ERE do të monitorojë zbatimin nga i licencuari të kushteve të licencimit, do të shqyrtojë raportet e marra nga i licencuari dhe në çdo kohë pas njoftimit, është i autorizuar të inspektojë asetet ose regjistrimet e llogarive dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose kontabël të aktiviteteve të të licencuarit.

7.2 Përfaqësuesit e autorizuar të ERE-s kanë të drejtë të hyjnë në ndërtesat e të licencuarit, pajisjet dhe dokumentet për të monitoruar aktivitetin e licencuar në përputhje me rregulloret dhe rregullat e ERE-s. I licencuari do të sigurojë çdo informacion ose dokument të kërkuar, të nevojshme për ERE-n gjatë këtij monitorimi.

7.3 Në bazë të ankesës së vërtetuar të çdo personi të tretë ose në bazë të vetë propozimit të tij, ERE mund të nisë një hetim për zbatimin e kushteve të licencës ose rregulloreve dhe rregullave të ERE-s, përfshirë shqyrtimin e praktikave të biznesit nga të licencuarit lidhur me aktivitetin e licencuar.

7.4 Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i licencuari nuk ka zbatuar kushtet e licencës dhe legjislacionin në fuqi. ERE mund të korigjojë tarifën e të licencuarit të ngarkuar me përgjegjësinë e furnizuesit universal dhe/ose të ndërmarrë masa të tjera ndaj të licencuarit, sipas kësaj licence me qëllim që të mbrojë interesat e konsumatorëve të energjisë elektrike, duke ndëshkuar atë me gjobë e deri në heqjen e kësaj licence.

7.5 I licencuari do të informojë ERE-n për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës dhe legjislacionit në fuqi brenda një jave që kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.

7.6 I licencuari do të zbatojë të gjitha urdhërimet apo vendimet e nxjerra nga ERE, përfshirë pagesën e plotë të gjobave të vendosura nga ERE.

## 8. Amendamenti i licencës

8.1 ERE mund të amendojë kushtet e licencës në rast se ato nuk përputhen, me:

a) Legjislacionin në fuqi dhe vendimet e qeverisë së Republikës së Shqipërisë që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) Vendimet e nxjerra nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ose një gjykatë tjetër shqiptare me kompetencë juridiksionale.

8.2 Në çdo kohë i licencuari ose ERE mund të propozojnë amendamente të tjera për këto kushte licence, duke i transmetuar palës tjetër një propozim me shkrim, së bashku me dokumentet mbështetëse.

8.3 ERE do të marrë vendimin përfundimtar vetëm pasi të marrë në konsideratë interesat e konsumatorëve dhe të të licencuarve të tjerë. Palët e interesuara do të informohen me shkrim për çdo amendament të propozuar. Nëse ERE dhe i licencuari arrijnë një marrëveshje për këto amendamente, kushtet e licencës do të amendohen. Nëse marrëveshja nuk arrihet, i licencuari mund të apelojë në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

8.4 Amendamentet e bëra në kushtet e licencës do të publikohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë 30 (tridhjetë) ditë para se të hyjnë në fuqi.





### 9. Përfundimi i licencës

9.1 ERE mund ta përfundojë licencën në përputhje me ligjin nr. 43/2015, kur:

- a) i licencuari kërkon revokimin e licencës;
- b) i licencuari shkel kushtet e licencës;
- c) i licencuari shkel legjislacionin në fuqi;
- d) i licencuari deklarohet i falimentuar dhe është i paaftë të përmbushë detyrimet e kushteve të licencës;
- e) i licencuari ka marrë licencë duke mashtruar;
- f) kur kontraktin me të tretë për dhënie e shërbimit sipas aktivitetit të licencuar.

9.2 Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksionari/ortaku që kontrollon interesin ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) ose anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence.

### 10. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta për apelim

10.1 Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë mes të licencuarit dhe çdo pjesëmarrësi tregu do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirëkuptim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

10.2 Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE, në bazë të kërkesës së çdo personi që është palë në këtë mosmarrëveshje do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e saj.

10.3 I licencuari mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në Gjykatën Administrative Tiranë.

Republika e Shqipërisë  
Enti Rregullator i Energjisë

### LICENCË PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Numri i licencës:

Certifikata e regjistrimit:

Seria:

Data e hyrjes në fuqi:

Licenca i jepet:

Shoqëria:

NUIS:

Detyrimi për shërbimin publik: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi:

Kohëzgjatja:

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në pjesën e pestë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep këtë licencë prodhimi (licenca), për të kryer aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (PEE) ose/dhe për të përmbushur detyrimin e shërbimit publik/universal, personit të lartpërmendur, i quajtur “i licencuari”, subjekt i kushteve të kësaj licence, si dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE-ja në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.

KRYETARI I ERE-s

### VENDIM

Nr. 100, datë 17.6.2016

### MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESIT E SHËRBIMIT UNIVERSAL

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa “a” dhe 98, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 5 dhe 14, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/



KESH sh.a. dhe furnizuesit të shërbimit universal, OSHEE sh.a.,

konstatoi:

- Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- në nenin 14 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, parashikohet se: Këto rregulla do të shërbejnë si model i përkohshëm për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, deri në miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Enti Rregullator i Energjisë, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë aktet përkatëse për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këto kushte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e kontratës “Për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe furnizuesit të shërbimit universal, OSHEE sh.a.”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 101, datë 23.6.2016

**MBI MIRATIMIN E DISA  
NDRYSHIMEVE NË MODELIN E  
KONTRATËS SË SHITBLERJES SË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET  
KESH SHA (FPSH) DHE PRODHUESVE  
TË VEGJËL TË ENERGJISË (PVE)  
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 80,  
DATË 23.10.2009, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 11 dhe

Faqe | 10354

14, të kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit të transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, miratuar me VKM-në nr. 244, datë 30.3.2016, nenit 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me disa ndryshime në Modelin e Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Me VKM nr. 244, datë 30.3.2016, janë miratuar rregullat “Mbi kushtet për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike”, në nenin 14 të të cilit është parashikuar se: Enti Rregullator i Energjisë, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë aktet përkatëse për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këto kushte.

- ERE, me vendimin nr. 62, datë 13.5.2016 ka filluar procedurat për miratimin e disa ndryshimeve në kontratën për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 80, datë 23.10.2009.

- ERE konsultoi me të gjitha palët e interesit ndryshimet e draftkontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 80, datë 23.10.2009.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar, me përmbajtjen si më poshtë:

A1. Në titull, pjesën hyrëse dhe kudo në kontratë me Palët do të referohen në cilësinë e



shitësit, prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe në cilësinë e blerësit Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSHEE sh.a.

A2. Paragrafi 5, në pjesën hyrëse, ndryshon dhe bëhet:

- ERE, me vendim të saj nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, ka licencuar shoqërinë \_\_\_\_\_ për prodhimin e energjisë elektrike; nga HEC/et \_\_\_\_\_, siç është përcaktuar në licencën e dhënë nga ERE. OSHEE sh.a., i cili është i ngarkuar me detyrimin i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë, duhet të nënshkruajë një kontratë për blerjen e energjisë elektrike me prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, në zbatim të nenit 11, pika 2, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.

ERE ka autoritetin të përcaktojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike për prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, sipas nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e rinovueshme”.

A3. Në nenin 1 “Përkufizime” bëhen ndryshimet si më poshtë:

Termi “furnizues publik me shumicë”, zëvendësohet me termin “OSHEE” sipas përkufizimit, në vijim OSHEE është personi juridik i licencuar përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes të shtrirë në një zonë të caktuar dhe kur është e aplikueshme lidhjen e tij me sisteme të tjera e të siguruar aftësi afatgjate të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë, i cili është i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë në zbatim të nenit 11, pika 2, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.

A4. Në pjesën përkufizime, termi “prodhues i vogël i energjisë elektrike” zëvendësohet me termin “prodhuesit me përparësi” sipas përkufizimit “prodhuesit me përparësi janë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike”, sipas përcaktimeve të ligjit për energjitë e rinovueshme të energjisë elektrike.

A5. Në pjesën përkufizime, termi “ligj” ndryshon dhe bëhet: - ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligji nr. 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”; ligji “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

A6. Në nenin 6.4, termi “vendi i autorizuar” ndryshohet me termin “subjekt i autorizuar”.

A7. Në nenin 6.10 “Në çdo rast përfaqësuesit e autorizuar të OSHEE sh.a., në bazë të Kodit të Matjes dhe me cilësinë e blerësit të energjisë mund të kryejnë konform legjislacionit në fuqi inspektime dhe testime të sistemit të matjes dhe sistemet e tyre të regjistrimit. Punonjësi i impiantit përkatës do t’i vejë në dispozicion përfaqësuesve të OSHEE sh.a. regjistrin e leximit të matësit të energjisë elektrike dhe do t’i krijojë aksesin e nevojshëm për të kontrolluar sistemin e matjes.

A8. Në nenin 7 hiqet germa “b” e pikës 1 të këtij neni.

A9. Në nenin 8, në paragrafin e fundit, hiqen fjalët: të mbajtur me përfaqësuesit e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

A10. Kjo kontratë do të jetë në fuqi për një periudhë 15-vjeçare (pesëmbëdhjetëvjeçare). Për subjektet që kanë një kontratë të shitblerjes së energjisë elektrike me KESH sh.a. para apo në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike me OSHEE sh.a. do të lidhet për periudhën e mbetur nga përfundimi i kontratës së lidhur me KESH sh.a.

2. Bashkëlidhur kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, në të cilën janë reflektuar ndryshimet e miratuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet KESH sh.a. që brenda datës 30.6.2016 t’i transferojë OSHEE sh.a., çdo dokumentacion që disponon nga kontratat e lidhura me prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të këtij vendimi.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a.,



KESH sh.a. dhe të licencuarit në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

KONTRATË  
PËR SHITBLERJE TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NDËRMJET OSHEE SHA  
DHE PRODHUESVE ME PËRPARËSI TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE

E lidhur sot, në datën \_\_\_\_\_, në Tiranë, ndërmjet:

**Shoqërisë** \_\_\_\_\_, person juridik shqiptar, regjistruar në \_\_\_\_\_ me vendim nr. \_\_\_\_\_, me nr. NIPT-i \_\_\_\_\_ me seli të shoqërisë \_\_\_\_\_, këtu e më poshtë e quajtur **“shitësi”**, përfaqësuar nga znj./z. \_\_\_\_\_;

*dhe*

**Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSHEE sh.a.**, shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik \_\_\_\_\_, me seli në adresën: rruga \_\_\_\_\_, Tiranë, këtu e më poshtë e quajtur **“blerësi”**, përfaqësuar nga znj./z. \_\_\_\_\_;

**Duke qenë se:**

Shoqëria \_\_\_\_\_, ka marrë me koncesion/ka privatizuar, HEC-in/et \_\_\_\_\_, sipas marrëveshjes së koncesionit/sipas kontratës së shitblerjes \_\_\_\_\_;

**Palët janë** përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj kontrate;

ERE me vendim të saj nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, ka licencuar shoqërinë \_\_\_\_\_ për prodhimin e energjisë elektrike; nga HEC/et \_\_\_\_\_ siç përcaktuar në licencën e dhënë nga ERE.

OSHEE sh.a., i cili, është i ngarkuar me detyrimin i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë duhet të nënshkruajë një kontratë për blerjen e energjisë elektrike me prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, në zbatim të nenit 11, pika 2, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, *“Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit*

*transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”*.

ERE ka autoritetin të përcaktojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike për prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, sipas nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 138/2013, *“Për burimet e rinovueshme”*.

**Palët** bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1  
**Përkufizime**

Në këtë kontratë, termat e mëposhtëm do të kenë kuptim si vijon:

**“Çmimi”** do të thotë çmimi i shitblerjes së energjisë elektrike, i vendosur nga Enti Rregullator i Energjisë sipas legjislacionit në fuqi;

**“Dita”** do të thotë një periudhë kohore prej 24 orësh, e cila fillon në orën 00:00 deri në 24:00;

**“Energjia elektrike ose energjia”** nënkupton energjinë elektrike aktive dhe energjinë elektrike reaktive të transmetuar dhe të shpërndarë nga sistemi elektroenergjetik;

**“Energji elektrike aktive”** është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe dhe përcaktohet nga integrali i caktuar i fuqisë aktive në kufijtë e kohës. Njësia matëse e saj është vat/orë ose shumëfisha të saj;

**“Energji elektrike reaktive”** është integrali i caktuar me kufijtë kohë i fuqisë reaktive matur në njësi me volt-amper reaktive-orë ose shumëfisha të saj;

**“ERE”**, Enti Rregullator i Energjisë;

**“Frekuenca”** numri i cikleve alternative të rrymës për sekondë, në të cilin funksionon sistemi elektroenergjetik;

**“Forcë madhore”** është një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si: tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë Palën/Palët kontraktuese të përmbushin detyrimet përkatëse sipas kësaj kontrate, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të Palës/Palëve dhe nuk ndodhin për faj të tij/tyre dhe Pala/Palët nuk është/janë në gjendje t'i eliminojë ato, edhe pse ka/në ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tij/tyre.

Defektet në pajisjet ose materialet ose vonesat për t'i bërë ato të disponueshme, konfliktet e



punës, grevat ose problemet financiare nuk mund të kërkohet të konsiderohen nga Palët si forcë madhore, përveç rastit kur burojnë nga një rrethanë e lidhur me forcën madhore.

“OSHEE” është personi juridik i licencuar përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes të shtrirë në një zonë të caktuar dhe kur është e aplikueshme lidhjen e tij me sisteme të tjera e të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë i cili është i ngarkuar me detyrimin i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë në zbatim të nenit 11, pika 2, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

“Prodhuesit me përparësi” janë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të ligjit për energjitë e rinovueshme të energjisë elektrike.

“Kontrata”, kjo kontratë e nënshkruar për shitblerjen e energjisë elektrike, e lidhur midis prodhuesit me përparësi të energjisë (shitësit) dhe OSHEE sh.a. (blerësit), si dhe çdo shtesë apo amendim që mund t’i bëhet asaj në të ardhmen;

“Ligj”, ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligji nr. 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”; ligji “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

“Matës”, domethënë një pajisje për matjen dhe regjistrimin e vlerave të matura të energjisë elektrike.

“Muaji” do të thotë periudha kohore e cila fillon në orën 00:00 p.d. të ditës së parë kalendarike të muajit dhe mbaron në orën 24:00 të ditës së fundit kalendarike të po atij muaji;

“Palë”, shitësi dhe blerësi në këtë kontratë;

“Pikë livrimi”, për efekt të kësaj kontrate, pika e livrimit do të jetë në zbarat dalëse të tensionit të mesëm të kabinës apo të nënstacionit të impiantit prodhues;

“Pikë matje” është pika e livrimit në të cilën sistemi i matjes plotëson të gjitha kushtet teknike

dhe të saktësisë sipas Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE për këtë qëllim;

“Sistemi i matjes së energjisë elektrike ose sistemi i matjes” është tërësia e pajisjeve të matjes: matësi, automati, transformatorët e rrymës, mbrojtje e matësit dhe izolatorët, qarqet dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave, pajisjet e transmetimit dhe të komunikimit të të dhënave dhe lidhjet e nevojshme kabllore, të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të energjisë elektrike aktive dhe energjisë elektrike reaktive në objekt;

“Viti” do të thotë periudha kohore e cila fillon në orën 00:00 të ditës së parë të vitit kalendarik dhe mbaron në orën 24:00 të ditës së fundit të po atij viti kalendarik.

## Neni 2

### Qëllimi i kontratës

Kjo kontratë përcakton termat dhe kushtet në të cilët blerësi do të jetë i detyruar të blejë, dhe shitësi do të jetë i detyruar të shesë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar nga shitësi si prodhues me përparësi i energjisë elektrike, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë qëllim.

## Neni 3

### Livrimi, pranimi dhe transferimi i të drejtave

1.1 Shitësi, në përputhje me këtë kontratë, duhet të programojë, të prodhojë e të shesë dhe blerësi duhet të programojë, të pranojë dhe të blejë të gjithë sasinë e prodhuar të energjisë elektrike në pikën e livrimit.

1.2 Shitësi është i detyruar të marrë masat e duhura të lidhë impiantin prodhues të energjisë elektrike me pikën e lidhjes, të përcaktuar sipas specifikimeve dhe rregullave të përcaktuara në Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Matjes dhe akteve të tjera.

1.3 Energjia elektrike do të transmetohet nga shitësi tek blerësi në pikën e livrimit, ku dhe pronësia e energjisë do të kalojë nga shitësi te blerësi.

1.4 Blerësi do t’i paguajë shitësit sasinë e blerë të energjisë elektrike me çmimin e kontratës dhe sipas rregullave të përcaktuara në nenin 8 (faturimi dhe pagesa).



1.5 Blerësi bie dakord që të pranojë sasi të tjera shtesë të energjisë elektrike nga ana e shitësit, në rast të një prodhimi më të madh nga ky i fundit. Për këtë shitësi duhet të bëjë njoftimet përkatëse për t'i mundësuar blerësit marrjen e energjisë, si dhe rregullimin e programit të tij.

1.6 “Pavarësisht detyrimit që ka OSHEE për të blerë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar nga shitësi, shitësi ka të drejtë të shesë të gjithë ose pjesë të energjisë së prodhuar subjekteve të tjera të ndryshme nga OSHEE-ja, në sasi të dhe mënyrat e zgjedhura nga vetë shitësi”. Grafiku i livrimit për energjinë që do të shitet në tregun e parregulluar do të jetë në bandë sipas profilit 00:00–24:00.

#### Neni 4

### Dokumentacioni paraprak, tensioni, frekuenca

1.1 Shitësi do t'i vërë në dispozicion/dorëzohë blerësit të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat lidhur me testimet dhe transmetimin e energjisë, specifikimet teknike të të gjitha pajisjeve elektrike të instaluar, përfshirë këtu edhe certifikatat e specifikimeve, detajet e matësve dhe pajisjeve të sigurisë të instaluar, 30 ditë përpara se impianti prodhues të vihet në shfrytëzim të plotë e të fillojë prodhim/livrimin e energjisë.

1.2 Energjia elektrike duhet të livrohet me tension dhe frekuencë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### Neni 5

### Programet e livrimit

1. Impiantet prodhuese, me fuqi të instaluar mbi 5 mw, duhet të programojnë dhe të paraqesin te blerësi programet e livrimit në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

2. Impiantet prodhuese, me fuqi nën 5 mw, do të paraqesin programin mujor/vjetor sipas sasisë së energjisë elektrike që parashikohet të prodhohet.

3. “Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga OSHEE-ja, impiantet prodhuese duhet të deklarojnë programet e tyre të livrimit dhe kontratat përkatëse për ditën në avancë”, si dhe planifikimin vjetor ku përcakton sasinë e energjisë elektrike që shitësi do të shesë në OSHEE sh.a. dhe në tregun e parregulluar të energjisë elektrike. Ky planifikim dërgohet në OSHEE sh.a. brenda datës 30 nëntor të vitit aktual për vitin pasardhës. Nominimi i programit përkatës do të bëhet në Faqe|10358

përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike.

4. Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga OSHEE-ja, ndaj impianteve prodhues zbatohen rregullat e tregut mbi disbalancat.

5. Devijimet nga programet e paraqitura do të trajtohen në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike apo çdo akti tjetër të miratuar nga ERE-ja për këtë qëllim.

#### Neni 6

### Matja e energjisë elektrike të livruar

6.1 Palët në këtë kontratë do të sigurojnë njëra-tjetrën se livrimet dhe pranimi i energjisë elektrike do të maten ose verifikohen me sistem matjeje në përputhje me procedurat dhe standardet e përcaktuara në Kodin e Funksionimit të Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike.

6.2 Matja e energjisë elektrike, të livruar nga shitësi te blerësi, do të kryhet në pikën e matjes/livrimit, e cila do të jetë në pronësi të shitësit, konform rregullave të përcaktuara në Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike. Për përcaktimin e instalimit, mirëmbajtjes, kontrollit, testimit dhe vulosjes së sistemit të matjes të energjisë elektrike, Palët i referohen Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike.

6.3 “Kur prodhuesi/shitësi vendos të operojë si në tregun e rregulluar si në tregun e parregulluar, impiantet prodhuese duhet të jenë të pajisura me sistem telematje me bazë orare të integruar me sistemin e matjes së OST-së”.

6.4 Matësi kontrollohet, kolaudohet dhe vuloset në prezencë të subjektit të autorizuar të shitësit dhe OSHEE sh.a.

6.5 Kolaudimi kryhet në subjektet e autorizuar dhe certifikuar sipas Kodit të Matjes së Energjisë.

6.6 Në ditën e caktuar nga Palët në kontratë (ose në ditën e fundit të muajit përkatës), përfaqësuesit e autorizuar të shitësit dhe blerësit do të takohen për të lexuar aparatit matës të energjisë elektrike, që përcakton sasinë mujore të energjisë së livruar nga shitësi te blerësi çdo muaj. Tregimi i numeratorit të matësit do të lexohet dhe regjistrohet çdo muaj për të realizuar kryerjen e bilancit të shitblerjes së energjisë elektrike. Në rast të mosfunksionimit të sistemit të matjes, për shkak të defekteve, marrja e të



dhënave do të përcaktohet me marrëveshje midis Palëve, duke iu referuar regjistrave të leximit të matjes.

6.7 Për leximin e matjes, të realizuar sipas pikës 6.3 të këtij neni, do të mbahet një procesverbal (akt rakordim) i leximit të aparatit matës, që do të firmoset nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve që kryejnë leximin, me përmbajtjen si më poshtë:

- a) të dhënat e sistemit të matjes (aparati matës dhe transformatorët e matjes);
- b) identitetin e personave që bëjnë leximin;
- c) nënshkrimin e personave;
- d) leximin e matësit për muajin paraardhës;
- e) leximin aktual të matësit.

6.8 Në rastet kur përfaqësuesi i blerësit nuk paraqitet në datën e caktuar, shitësi do të kryejë procesin e faturimit konform rregullave në fuqi dhe do t'i dërgojë blerësit faturën. Blerësi është i detyruar të shlyejë vlerën e faturuar. Çdo paqartësi për saktësinë e faturës nga ana e blerësit, do të jetë objekt rishikimi dhe rregullimi në muajt e ardhshëm.

6.9 Blerësi duhet të mbajë në impiantet /instalimet përkatëse të prodhimit të energjisë regjistrin (manual) të leximit të matësit, i cili duhet t'i vihet në dispozicion për inspektime /testime përfaqësuesve të autorizuar të blerësit dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut që kanë akses ligjor.

6.10 Në çdo rast përfaqësuesit e autorizuar të OSHEE sh.a., në bazë të Kodit të Matjes dhe me cilësinë e blerësit të energjisë mund të kryejnë, konform legjislacionit në fuqi, inspektime dhe testime të sistemit të matjes dhe sistemet e tyre të regjistrimit. Punonjësi i impiantit përkatës do t'i vejë në dispozicion përfaqësuesve të OSHEE sh.a. regjistrin e leximit të matësit të energjisë elektrike dhe do t'i krijojë aksesin e nevojshëm për të kontrolluar sistemin e matjes.

6.11 Mbas instalimit të sistemit të matjes dhe regjistrimit të të dhënave *online*, shitësi është i detyruar të bëjë transmetimin e këtyre të dhënave, sipas këtij sistemi, përveç rasteve të pamundësive teknike për montimin e sistemit *online* të matjes.

Neni 7

### Dokumentimi i procesit të livrimit/pranimit dhe matjes

7.1 Sipas një kërkesë të arsyeshme, Palët do t'i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë, i cili evidenton sasinë, livrimet dhe

pranimet e energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të masës dhe shkakut të çdo devijimi nga programet.

7.2 Nëse njëra Palë, me kërkesë të Palës tjetër ose për të zgjidhur një mosmarrëveshje të ngritur nga Pala tjetër, kryen shpenzime të arsyeshme të jashtme, për të verifikuar nëse Pala tjetër ka dështuar të përmbushë siç duhet detyrimet e saj sipas termave të kësaj kontrate këto shpenzime do të rimbursohen nga Pala që nuk ka përmbushur detyrimet, nëse kjo kërkohet.

Neni 8

### Faturimi dhe pagesa

8.1 Fatura: shitësi do t'i dorëzojë blerësit për livrimin e energjisë elektrike një faturë sipas formatit dhe standardeve që kërkon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasinë totale të energjisë elektrike të shitur prej tij në muajin kalendarik paraardhës. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës (ose kur kjo datë është pushim zyrtar, ditën pasardhëse të punës). Krahas faturës, shitësi do t'i dorëzojë blerësit edhe aktrakordimin përkatës.

8.2 Pagesa: blerësi do t'i kryejë pagesën shitësit kundrejt vlerës së faturës mujore. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të faturës nga blerësi. Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e blerësit preken fondet monetare.

8.3 Vonesa në kryerjen e pagesës: nëse blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, konsiston në pagimin e kamatëvonesës në masën e normës së interesit të bonove thesarit me maturim 1-vjeçar + 0.5% në vit për çdo ditë vonesë të llogaritura nga data në të cilën do të kryhet pagesa. Kamatëvonesa paguhet pa qenë i detyruar kreditori (shitësi) të provojë ndonjë dëm. Në llogaritjen e kamatëvonesës nuk përfshihet data kur kryhet pagesa.

8.4 Shumat e diskutueshme: për çdo pretendim që lidhet me saktësinë e faturës, do të jepet një shpjegim me shkrim nga shitësi ose blerësi dhe korrektimet në faturë do të bëhen vetëm brenda muajit të faturuar, në të kundërt do të paguhet shuma e faturuar jo më vonë se data e afatit të pagesës dhe diferencat (shtesat apo pakësimet) nga korrektimet do të reflektohen në muajt pasardhës.



## Neni 9

**Detyrimet mbi taksat dhe tatimet**

9.1 Palët janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me të gjitha tarifatat, taksat, tatimet sipas legjislacionit në fuqi.

9.2 Shitësi do të paguajë të gjitha detyrimet lidhur me taksat, tatimet apo çdo detyrim tjetër sipas legjislacionit në fuqi në ose/dhe para pikës së livrimit dhe blerësi do të paguajë të gjitha detyrimet lidhur me taksat, tatimet apo çdo detyrim tjetër sipas legjislacionit në fuqi pas pikës së livrimit.

## Neni 10

**Risku dhe humbja**

10.1 Palët në fillim të çdo viti do të hartojnë dhe do të koordinojnë programet e remonteve të planifikuara, si dhe shërbimet për centralin dhe të linjave dhe pajisjeve elektrike të OSHEE sh.a.

10.2 Shitësi do të përballojë të gjitha risqet shoqëruese dhe do të jetë përgjegjës për çdo kosto ose pagesë të imponuar që lidhet me programimin, transmetimin dhe livrimin e sasisë së energjisë elektrike të kontraktuar deri në pikën e livrimit, në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike dhe akteve të tjera në fuqi, përveç rastit kur livrimi i energjisë është i pamundur si rezultat i rrethanave që nuk varen nga shitësi ose në rast se moslivrimi justifikohet nga riparimet vjetore dhe mirëmbajtjes sipas pikës 1 të këtij neni.

10.3 Blerësi do të përballojë të gjitha risqet shoqëruese dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të imponuar që lidhet me pranimin dhe transmetimin e sasisë së kontraktuar pas pikës së livrimit, përveç rastit kur moslivrimi i energjisë është i pamundur si rezultat i rrethanave që nuk varen nga blerësi (forcë madhore) ose në rast se moslivrimi justifikohet nga avaritë në linjat dhe pajisjet elektrike të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

## Neni 11

**Çmimi**

1. Blerësi paguan shitësin për energjinë elektrike të blerë, me çmimin e miratuar, nga ERE sipas legjislacionit në fuqi.

2. Çmimi i aplikueshëm në momentin e lidhjes së kësaj kontrate është çmimi në fuqi i miratuar nga ERE për periudhën rregullatore përkatëse.

3. Nëse ERE miraton një çmim të ndryshëm nga ai i aplikuar sipas paragrafit 11.2, Palët do të

bëjnë korrigjimet e nevojshme për sasi të e faturuara në përputhje me vendimin përkatës të ERE-s.

## Neni 12

**Forca madhore**

1. Në qoftë se secila Palë përballlet me forcën madhore, ajo do të njoftojë Palën tjetër pa vonesë nëpërmjet një njoftimi me shkrim të konfirmuar si e marrë nga Pala tjetër, duke i bërë të qartë kësaj të fundit natyrën e ngjarjes, kohëzgjatjen e mundshme dhe pasojat e pritshme.

2. Asnjëra Palë nuk do të konsiderohet përgjegjëse për mospërmbushje të detyrimeve kontraktore në qoftë se ajo ka qenë penguar për realizimin e tyre nga forca madhore.

3. Palët do të ndërmarrin masat e nevojshme për të reduktuar minimalisht dëmet.

## Neni 13

**Kompensimet për mospranimin e energjisë elektrike**

13.1 Kur blerësi nuk përmbush detyrimin për të pranuar energji nga shitësi sipas kësaj kontrate dhe kur një mospërmbushje e tillë nuk justifikohet nga një rast i forcës madhore, atëherë blerësi duhet të kompensojë shitësin për dëmin financiar të shkaktuar, të barabartë me produktin sasisë së energjisë të papranuar me çmimin e rregulluar nga ERE, në fuqi.

13.2 Shuma e paguar në përputhje me këtë nen, do të faturohet dhe paguhet sipas nenit 9 (faturimi dhe pagesa).

13.3 Asnjëra nga Palët nuk do të jetë e detyruar të kompensojë humbjet e Palës tjetër si rezultat i riparimeve apo mirëmbajtjes (përfshirë këtu edhe riparimet e urgjencës) të realizuara në përputhje me programin e rënë dakord nga Palët.

## Neni 14

**Përfundimi i kontratës**

1. Palët kanë të drejtë të përfundojnë kontratën në qoftë se reciprokisht bien dakord për këtë gjë. Palët njoftojnë ERE brenda 5 ditësh për përfundimin e kontratës.

2. Në qoftë se gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës secila Palë vëren një shkelje serioze të detyrimit kontraktor nga ana e Palës tjetër, menjëherë do ta njoftojë këtë të fundit me shkrim lidhur me këtë.





3. Pala tjetër brenda një afati kohor prej 10 ditësh nga marrja e njoftimit duhet të ndreqë ose kompensojë shkeljen e pretenduar të detyrimit kontraktor ose në rast të mospajtimit lidhur me pretendimin do t'i shprehë Palës tjetër me shkrim këtë mospajtim duke përcaktuar në të edhe argumentimet e veta për këtë.

4. Në qoftë se brenda afatit 10-ditor si më sipër nuk është bërë ndreqja apo kompensimi i shkeljes kontraktore ose Pala që ka bërë shkeljen nuk i ka shprehur Palës tjetër mospajtimin me shkrim brenda këtij afati, atëherë Pala që pretendon shkeljen mund të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës.

5. Palët do të kenë të drejtë të kërkojnë përfundimin e kontratës në mënyrë të njëanshme në qoftë se ato nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet kontraktore sipas kësaj kontrate për një periudhë kohore pa ndërprerje më shumë se 6 muaj si rezultat i forcës madhore.

6. Palët kanë të drejtë të kërkojnë përfundimin e kontratës, kur:

a) njëra nga Palët falimenton ose nuk është në gjendje të paguajë borxhet ose dështon, ose pranon me shkrim paaftësinë e saj të përgjithshme për të paguar borxhet kur duhet;

b) në rast se njëra nga Palët ka dhënë garanci jokorrekte dhe të pavërteta;

c) në rast të shkeljes nga ana e Palëve të rregullave dhe kërkesave teknike të parashikuara nga aktet nënligjore në fuqi.

7. Përfundimi i kontratës sipas paragrafëve 14.4, 14.5, 14.6 të këtij neni bëhet me miratimin e ERE-s.

8. Palët do të llogarisin brenda 30 ditëve pune, duke filluar nga dita e përfundimit të kontratës, detyrimet financiare respektive dhe mënyrat e shlyerjes së tyre.

Neni 15

#### **Afati i kontratës**

Kjo kontratë do të jetë në fuqi për një periudhë 15-vjeçare (pesëmbëdhjetëvjeçare). Për subjektet që kanë një kontratë, të shitblerjes së energjisë elektrike me KESH sh.a. para apo në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike me OSHEE sh.a. do të lidhet për periudhën e mbetur nga përfundimi i kontratës së lidhur me sh.a.

Neni 16

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo kontratë, dispozitat e së cilës janë miratuar nga ERE, hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga Palët.

Neni 17

#### **Ndryshimet**

Në qoftë se ndonjë term, kusht apo rregull i kësaj kontrate do të bëhet i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm plotësisht apo deri në njëfarë mase, ky term, kusht apo rregull nuk do të sjellë pavlefshmërinë, paligjshmërinë apo pazbatueshmërinë e kushteve, termave dhe rregullave të parashikuar me pjesën tjetër të kësaj kontrate.

Neni 18

#### **Legjislacioni**

Kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike do të bazohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 19

#### **Njoftimet**

1. Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 20

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Në rast të mosmarrëveshjeve, blerësi dhe shitësi do të bëjnë fillimisht përpjekje të zgjidhin konfliktin me mirëkuptim. Nëse Palët nuk gjejnë mirëkuptim, ato mund të kërkojnë ndërhyrjen e ERE-s.

2. Palët në çdo rast kanë të drejtën e zgjidhjes së konfliktit në rrugë gjyqësore ose në arbitrazh sipas përcaktimeve të bëra nga vetë Palët. Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis Palëve, që rrjedhin nga kjo kontratë do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 21

#### **Personat përgjegjës (administratorët) e kontratës**

1. Secila Palë do të caktojë në këtë kontratë personin që do të jetë përgjegjës, për interes të Palës respektive, për kryerjen e komunikimeve



përkatëse dhe për përfaqësimin e saj në problematikën që lidhen me ekzekutimin e kësaj kontrate.

2. Secila Palë do të njoftojë menjëherë Palën tjetër për ndonjë ndryshim lidhur me personin e caktuar përgjegjës. Nëse ndonjëra nga Palët nuk bën informimet e duhura, atëherë pala do të marrë mbi vete të gjitha përgjegjësitë lidhur me ndonjë dëm të mundshëm që rrjedh si rezultat i mosdhënies së informacionit të nevojshëm.

3. Personat përgjegjës e kësaj kontrate për Palët, sipas paragrafit të parë të këtij neni, do të jenë përkatësisht:

Për blerësin: \_\_\_\_\_

Për shitësin: \_\_\_\_\_

Neni 22

Kjo kontratë hartohet në 4 kopje të barasvlershme, nga të cilat 2 kopje qëndrojnë në OSHEE sh.a. dhe 2 kopje i mban shitësi.

Për shitësin  
Emërtimi juridik i Palës  
Personi i autorizuar  
i Palës  
Funksioni:  
Nënshkrimi dhe vula

Për blerësin  
OSHEE sh.a.

## VENDIM

Nr. 102, datë 23.6.2016

### **PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË OST SHA LIDHUR ME MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E TRANSMETIMIT, SHËRBIMET NDIHMËSE DHE DISBALANCAT**

Në mbështetje të neneve 1, 16 dhe 62, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM-në nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrjnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike."; Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008 dhe nenit 26 të Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të

Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e "Miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat",

konstatoi se:

- Marrëveshja e miratuar me vendimin nr. 79, datë 7.6.2016, "Për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjetik" midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.", i shtrin efektet e saj deri më 30 qershor 2016.

- Neni 62 i ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" parashikon se: *Operatori i Sistemit të Transmetimit prokuron energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjet, shërbimet e balancimit ose ato ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit, nëpërmjet një procedure konkurruese, jodiskriminuese dhe transparente.*

a) *Procedurat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, miratohen nga ERE pas propozimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.*

- *Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të sigurojë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjet, shërbimet e balancimit dhe ato ndihmëse me anë të kontratave bilaterale të miratuara nga ERE për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji".*

- Aktualisht në tregun shqiptar të energjisë vetëm njësitë gjeneruese të të licencuarit KESH sh.a. mund të shërbejnë për sigurimin e shërbimeve ndihmëse.

- Koha për kryerjen e procedurave të prokurimit për muajin korrik të humbjeve në rrjetin e transmetimit është shumë e shkurtër.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e OST sh.a. për të lidhur kontratë bilaterale me pjesëtarin e tregut KESH sh.a., për të siguruar shërbimet ndihmëse dhe balancimit për periudhën e mbetur të vitit 2016.

2. Për qëllime të prokurimit të humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit për muajin korrik 2016, OST-ja t'i sigurojë humbjet nga KESH sh.a., me çmimin mesatar të bursës hungareze HUPEX të të njëjtit muaj, për produktin/profilin në bandë, siç publikohet në *website-in* e kësaj burse ([www.hupe.hu](http://www.hupe.hu)).



3. Deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të rregullave të blerjes së energjisë elektrike, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, OST sh.a. të prokurojë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit në përputhje me “Rregulloren e procedurave të blerjes nga KESH sh.a., së energjisë elektrike, nga tregtarët vendas dhe të huaj”, miratuar me vendimin nr. 30, datë 23.3.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
Nr. 103, datë 23.6.2016

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES  
PËR PROCEDURAT E BLERJES SË  
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR  
MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET  
E SHPËRNDARJES DHE TË  
TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN  
DHE SHITJEN E ENERGJISË  
ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR  
PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË  
SHËRBIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa “i”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; Traktati i Komunitetit të Energjisë Elektrike, miratuar me ligjin nr. 9501 dhe nenin 26 të Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e rregullores “Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 151, datë 11.12.2015, filloi procedurat për miratimin e rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. të shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike”;

- në komunikim elektronik në datë 18 janar 2016 ENC ka propozuar një draft të përmirësuar të rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. të shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike;

- Traktati i Komunitetit të Energjisë Elektrike, miratuar me ligjin nr. 9501, vendos ERE-n përpara detyrimit për të përmbushur angazhimet e tij;

- drafti i propozuar për miratim nga ENC-ja i rregullores “Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, paraqet vështirësi për implementimin e menjëhershëm të këtyre rregullave.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

2. Kjo rregullore “Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, hyn në fuqi, jo më vonë se 4 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Deri në hyrjen në fuqi të këtyre rregullave OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., të operojnë me rregulloren e procedurave të blerjes nga KESH sh.a., të energjisë elektrike, nga tregtarët vendas dhe të huaj, miratuar me vendimin nr. 30, datë 23.3.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, rregulloren dhe procedurat e shitjes së energjisë elektrike miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe rregullat dhe procedurat e shkëmbimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 100, datë 27.12.2006, i ndryshuar, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

## RREGULLORE

PËR PROCEDURAT E BLERJES SË  
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E  
HUMBJEVE NË RRJETET E  
SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT  
DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E  
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË  
SIGURUAR PËRMBUSHJEN E  
DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK

### PJESA I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1

#### Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të ligjit nr. 43/2015 nenit 19, germa “I”, nenit 62, pika 2, nenit 69, germa “ë”, datë 28.5.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-në nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

##### Neni 2

#### Objekti dhe qëllimi

1. Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurat e blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike sipas nenit 6 më poshtë nga operatori i sistemit të shpërndarjes, operatori i sistemit të transmetimit dhe çdo kompani tjetër e energjisë elektrike për të cilën janë vendosur detyrimet e shërbimit publik (PSO) nga kompanitë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike.

2. Qëllimi i kësaj rregulloreje, është:

a) të përcaktojë procedura eficiente dhe praktike për kompanitë e energjisë elektrike, të cilave u jemi referuar në paragrafin 1 të këtij neni për blerjen e energjisë elektrike nga tregtarët;

b) të sigurojë blerje të energjisë elektrike me çmime sa më të ulëta;

c) të nxisë pjesëmarrjen e tregtarëve në procesin e blerjes së energjisë elektrike;

d) të nxisë konkurrencën në procesin e blerjes së energjisë elektrike;

e) të sigurojë transparencë, si dhe një trajtim të barabartë për të gjithë tregtarët dhe pjesëmarrësit në procedurat e blerjes së energjisë elektrike;

f) të përputhet me legjislacionin në fuqi.

##### Neni 3

#### Parimet

Procedurat e blerjes së energjisë elektrike sipas kësaj rregulloreje do të realizohen në përputhje me parimet e barazisë, konkurrencës, transparencës dhe parimet e ruajtjes së konfidencialitetit.

##### Neni 4

#### Përcaktime

Në këtë rregullore, termat e përdorur më poshtë do të kenë kuptimin:

1. **“ERE”** nënkupton Entin Rregullator të Energjisë, përgjegjës për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe aktet nënligjore në fuqi.

2. **“Blerësi”** nënkupton operatorin e sistemit të shpërndarjes, operatorin e sistemit të transmetimit dhe kompani të tjera të energjisë elektrike për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik (PSO) për shitjen dhe/ose blerjen e energjisë elektrike sipas licencave të lëshuara nga Enti Rregullator i Energjisë.

3. **“Blerje e energjisë elektrike”** do të thotë kalimi në sasi dhe në kohë i energjisë elektrike nga tregtarët e energjisë elektrike dhe/ose bursat energjetike të blerësi, sipas pagesës dhe kushteve të tjera të përcaktuara në kontratën përkatëse të shitblerjes dhe sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

4. **“Tregtar i energjisë elektrike”** do të thotë çdo person juridik/kompani vendase apo e huaj që ushtron aktivitet të licencuar, për tregtimin e energjisë elektrike me shumicë.

5. **“Kërkesa/ftesa për ofertë”** do të thotë dokumenti zyrtar që blerësi u drejton publikisht tregtarëve të energjisë elektrike për paraqitje të



ofertave, hartuar në formën e parashikuar në këtë rregullore.

6. **“Kodeve të funksionimit të rrjetit”** do të thotë Kodi i Rrjetit të Transmetimit, Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes, Kodi i Matjes.

7. **“Ofertues”** do të thotë tregtari i energjisë elektrike që paraqet një ofertë.

8. **“Ofertë”** do të thotë tërësia e informacionit dhe korrespondencës të dërguar në mënyrë elektronike administruar nga blerësi sipas rregullave në fuqi.

9. **“Kalendari i ofertave”** do të thotë kalendari i cili përfshin të gjitha ditët të cilat drejtojnë proceset e blerjes për 12 muajt në vazhdim. Ai do të përditësohet çdo muaj dhe do të vendoset në dispozicion të publikut. çdo ndryshim në kalendarin e ofertave duhet t’u njoftohet në kohë të gjithë tregtarëve të licencuar nga ERE dhe të regjistruar në tregun e energjisë elektrike në përputhje me Rregullat e Tregut.

10. **“Regjistri i tregtarëve të energjisë elektrike”** do të thotë një regjistër të të gjithë tregtarëve të energjisë elektrike, i cili mbahet nga blerësi, me kontaktet e personave përgjegjës për të siguruar informacionin për procesin e blerjes.

11. **“Terma komerciale”** janë tërësia e elementeve që kanë të bëjnë me kushtet teknike, sasinë, çmimet e shitblerjes, livrimin, kapacitetet e interkonjeksionit, si dhe tarifat ose pagesat e tjera që shoqërojnë transaksionin e blerjes.

12. **“Kapacitetet e transmetimit /interkonjeksionit”** janë kapacitetet e interkonjeksionit të cilat sigurohen nga blerësit dhe/ose tregtarët, për të mundësuar blerjen e energjisë elektrike.

13. **“Një platformë IT online”** do të thotë një platformë elektronike e publikimit të të dhënave të blerësit dhe shitësit në funksion të blerjes/shitjes së energjisë elektrike.

#### Neni 5 Përgjegjësitë

Blerësi është përgjegjës për përcaktimin e grafikut të fuqisë në MW dhe atë të energjisë elektrike në MWh përkatësisht (në kapacitet dhe sasinë e energjisë elektrike), si dhe për përcaktimin e periudhës kohore dhe programit të livrimit të saj, që duhet të llogaritet në përputhje me ligjin e sektorit të energjisë elektrike, Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, si dhe kodeve të funksionimit të rrjetit.

#### Neni 6 Zbatimi

Procedurat e blerjes së energjisë elektrike të përcaktuara në këtë rregullore, duhet të zbatohen:

a) nga operatori i sistemit të shpërndarjes dhe operatori i sistemit të transmetimit për të mbuluar humbjet respektivisht në rrjetin e shpërndarjes dhe atë të transmetimit;

b) nga kompanitë e energjisë për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik për shitjen dhe/ose blerjen e energjisë elektrike;

c) në rastin e blerjes së energjisë elektrike në kushte emergjente, përfshirë dhe pa u kufizuar tek avaritë e ndodhura në njësinë e shpërndarjes ose transmetimit të energjisë elektrike.

#### Neni 7 Formati i mbledhjes, paraqitjes dhe shqyrtimit të ofertave

1. Një platformë IT *online* duhet të përdoret nga blerësi për të gjitha ndërveprimet me tregtarët e energjisë elektrike në procesin e blerjes. Ajo duhet të vendoset në dispozicion *online*.

2. Blerësi duhet të drejtojë kalendarin e ofertave dhe regjistrin e tregtarëve të energjisë elektrike. Të gjitha ofertat, koha e paraqitjes dhe detajet e ofertës duhet të ruhen në sistem për një afat 5-vjeçar.

3. Paraqitja e ofertave nga tregtarët e energjisë elektrike, bëhet *online* në sistem sipas një hyrje të paracaktuar në ditën e paraqitjes së ofertave. Koha e hapjes dhe e mbylljes duhet të publikohen në kalendarin e ofertave.

4. Shqyrtimi i plotësimit të ofertave dhe vlerësimi i tyre, duhet të bëhet në mënyrë automatike përmes sistemit *online* të IT-së. Rezultatet e procedurave të tenderimit duhet të paraqiten në mënyrë automatike në **ERE** për shqyrtim dhe duhet të përmbajnë tregtarët e energjisë elektrike, të cilët kanë paraqitur ofertat, të gjithë informacionin në dispozicion të ofertave të marra dhe ofertat e përzgjedhura.

5. Blerësi, nëpërmjet sistemit *online* të IT-së, duhet të publikojë rezultatet e blerjes në mënyrë anonime dhe të grumbulluar, me çmime mesatare dhe sasi të blera për procedurat e blerjes.



## Neni 8

**Formati i ofertave**

1. Të gjitha ofertat e paraqitura në platformën *online* të blerjes për çdo proces prokurimi/blerje duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- emrin e ofertuesit;
- kapacitetin e ofruar/periudhën në (mw);
- çmimin/njësine/periudhën (euro/mwh);

2. Të gjitha ofertat duhet të jenë të pandryshueshme dhe të paraqiten për të gjithë periudhën për të cilën është prokuruar energjia elektrike. Kapaciteti i ofertave duhet të jetë midis 1 mw dhe kapacitetit total i siguruar për periudhën respektive.

3. Çdo proces prokurimi duhet të ketë një periudhë fikse për livrimin dhe një kapacitet fikse të prokuruar, për të gjithë periudhën që rezulton nga një sasi maksimale që mbulohet nga procesi i prokurimit. Kur mënyra e prokurimit parashikon kërkesa të ndryshme gjatë kësaj periudhe, duhet të organizohen prokurime të veçanta me periudha fikse livrimi dhe kapacitete fikse. Kjo nuk duhet të dëmtojë mundësinë e tregtarëve të energjisë elektrike për të paraqitur oferta, të cilat janë më pak se kapaciteti maksimal që është siguruar.

## Neni 9

**Kontratat për blerjen e energjisë elektrike**

1. Blerja ose shitja e energjisë elektrike nga kompanitë e energjisë të cilave iu jemi referuar në nenin 2(1) të rregullores kryhet mbi bazë të kontratave që lidhen si rrjedhojë e procedurave dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Kontratat duhet të hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi të sektorit të energjisë elektrike dhe atë civil.

3. Pika e livrimit gjithmonë duhet të jetë grupi i balancimit për blerësin sipas zonës detyruese shqiptare.

## Neni 10

**Publikimi i informacionit për blerjen e energjisë elektrike**

1. Për secilën blerje të energjisë elektrike, i gjithë informacioni specifikuar në paragrafin 2 më poshtë duhet të publikohet në kalendarin e ofertave, i cili duhet të vendoset në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut nga blerësi përmes platformës *online*.

2. Informacioni për çdo proces tenderimi dhe proces detyrues duhet të publikohet përmes platformës *online* të paktën duhet të përmbajë:

- sasinë e përgjithshme të energjisë elektrike në mwh që kërkohet për t'u blerë në çdo proces prokurimi/blerje të energjisë elektrike;

- kapacitetin maksimal të energjisë elektrike në mw që mund të ofrohet për çdo proces prokurimi/blerje;

- periudhën e plotë kohore të livrimit të energjisë elektrike të përcaktuar në marrëdhëniet kontraktuale të (shitblerjes);

- siguruesin e kapaciteteve të transmetimit;

- kërkesat për kualifikimin në procedurën e blerjes siç parashikohet në nenin 10;

- kriterin ose vlerësimin e ofertave në përputhje me nenin 12;

- kushtet e pagesave;

3. Blerësi duhet të publikojë çdo informacion të përfshirë në kalendarin e ofertave në gjuhën shqipe dhe angleze në faqen zyrtare të blerësit. Në rast mospërputhjes duhet të mbizotërojë informacioni në gjuhën shqipe.

4. Brenda një dite pune pas përfundimit të procesit të blerjes së energjisë elektrike, në platformën e IT-së për blerjet, duhet të publikohet informacioni i mëposhtëm.

- emrat e ofertuesve;

- kapacitetet e ofruara për çdo ofertë (mw);

- sasinë e ofruara për çdo ofertë (mwh);

- çmimi /njësia për çdo (euro/mwh);

- vlera totale për çdo proces blerje (euro);

- profilet e livrimit për çdo ofertë;

- pikat e livrimit të energjisë elektrike për çdo ofertë;

- vlefshmëria e të gjitha ofertave;

- shpallja e fituesve dhe/ose kompanive që nuk janë fituese.

5. Blerësi, duhet të publikojë në faqen zyrtare të internetit një kopje të të gjitha ankesave të paraqitura, si dhe të përgjigjeve për ankesën.

## Neni 11

**Dokumentacioni ligjor dhe administrativ**

1. Çdo shoqëri e licencuar për tregtimin e energjisë elektrike në Shqipëri dhe/ose çdo Palë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë që dëshiron të marrë pjesë në procedurën e blerjes së energjisë elektrike duhet t'i paraqesë blerësit, dokumetacionin e nevojshëm administrativ që



vërteton aftësinë e tij ligjore, si dhe atë të tregtimit të energjisë elektrike nga institucionet kompetente të shteteve përkatëse ku është regjistruar, si më poshtë vijon:

a) Dokumentacionin që vërteton regjistrimin e shoqërisë në regjistrat përkatës tregtarë /gjyqësorë të shtetit në të cilin shoqëria është krijuar apo regjistruar;

b) Licencën për tregtimin e energjisë elektrike të lëshuar nga ERE për tregtarët të cilët janë krijuar apo regjistruar në Republikën e Shqipërisë, apo shtetet përkatëse për ata tregtarë të energjisë elektrike të cilët janë krijuar apo regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë;

c) Dokumentacionin lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës **jo më vonë se 3 muaj** që nga paraqitja e ofertës i cili duhet të vërtetojë, që:

- tregtari nuk është në proces falimentimi (dokument i lëshuar nga QKR-ja);

- tregtari apo përfaqësuesit ligjore të shoqërisë nuk janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për shkelje penale;

- tregtari apo përfaqësuesit ligjore të shoqërisë nuk janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Këto kërkesa duhet të përmenden në mënyrë të qartë në njoftimin publik ku ftohen për të paraqitur kërkesat.

3. Tregtarët që nuk i përmbushin kërkesat e vendosura në paragrafin 1 duhet të konsiderohen si jo të përshtatshëm për të dhënë ofertë.

4. Tregtarët që shprehin për herë të parë interesin e tyre për të marrë pjesë në procedurat e blerjes së energjisë elektrike të zhvilluar nga blerësi, të cilët nuk kanë depozituar dokumentacionin ligjor të cilit i jemi referuar në paragrafin 1(c) të këtij neni, duhet të paraqesin dokumentacionin e mësipërm përmes platformës *online* së bashku me dokumentacionin e shprehjes së interesit.

5. Kompanitë e tjera të interesuara, të cilat janë të regjistruara për të ofertuar me blerësin, në ndonjë procedurë blerje në të ardhmen, duhet të paraqesin vetëm formatin e ofertës me të dhënat e specifikuar në nenin 8(1) të kësaj rregulloreje.

6. Blerësi nuk duhet të refuzojë kompanitë të cilat kanë paraqitur dokumentacionin e plotë, edhe nëse ai është paraqitur me pjesë, për të marrë pjesë në procedurat e blerjes së energjisë elektrike.

Neni 12

### Kriteret për vlerësimin e ofertave

Platforma e IT-së *online* për prokurimin/blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve apo energjinë që ka vendosur detyrimi i shërbimit publik (PSO) për blerësin duhet të vlerësojë ofertat e ardhura në mënyrë automatike me kohën e hapjes/mbylljes bazuar vetëm në çmimin për MWh. Platforma e IT-së duhet të zgjedhë të gjitha ofertat për të minimizuar kostot për çdo proces prokurimi duke bërë fitues ato oferta të cilat grumbullohen sipas rezultatit më të ulët të përgjithshëm për procesin. Në rastin kur ofertat kanë të njëjtën sasi dhe çmim duhet të aplikohet parimi i pari që vjen i pari shërbehet (first-come-first serve).

Neni 13

### Komunikimi i blerësit me pjesëmarrësit në procedurat për blerjen e energjisë elektrike

1. Çdo komunikim i blerësit me shoqëritë pjesëmarrëse në lidhje me procedurat e blerjes së energjisë, do të bëhet vetëm përmes platformës e IT-së *online* për prokurimin, pas regjistrimit të tregtarëve të energjisë elektrike.

2. Të gjitha njoftimet që ndryshojnë kalendarin e ofertave duhet të bëhen me shkrim dhe të publikohen në faqen e internetit të blerësit. Duhet të ndalohet çdo formë tjetër komunikimi ose negociimi midis blerësit dhe tregtarëve të energjisë elektrike ose midis tregtarëve të energjisë elektrike me njëri-tjetrin.

Neni 14

### Procedura e prokurimit të energjisë elektrike

1. Blerësi duhet të zhvillojë një strategji/mënyrë prokurimi të energjisë për të gjithë sasinë e humbjeve të parashikuara në rrjetin e shpërndarjes ose të transmetimit, ose të parashikojë energjinë që ka vendosur detyrimi i shërbimit publik (PSO) për blerësin, përgjatë gjithë vitit kalendarik. Ai duhet të përditësojë mënyrën e prokurimit të energjisë të paktën në baza mujore.

2. Të gjitha ndryshimet në strategjinë/mënyrën e prokurimit të energjisë elektrike, i cili ndikon në mënyrë direkte në sasinë dhe frekuencën e blerjes që çon në një ndryshimin në procesin e blerjes duhet të përfshihet në kalendarin e ofertave brenda një dite.



3. Mënyra/strategjia e prokurimit të energjisë ka si qëllim minimizimin e kostove për energjinë e prokuruar për gjatë gjithë vitit kalendarik.

4. Mënyra/strategjia e blerjes dhe përfaqësimi i saj në kalendarin e ofertave, duhet të përmbajë:

- sasinë e energjisë elektrike në mwh që do të blihet;

- periudhën dhe ditën e blerjes;
- grafikun ditor të livrimit të energjisë elektrike;
- kohëzgjatjen e livrimit të energjisë elektrike;
- datën/orën e paraqitjes së ofertave.

5. Çdo paraqitje e ofertës për blerjen e energjisë elektrike nga çdo ofertues duhet të kryhet përmes platformës së IT-së *online* për prokurimin /blerjen e energjisë elektrike.

6. Vlerësimi i ofertave duhet të zhvillohet në mënyrë automatike në përputhje me nenin 12 të kësaj rregulloreje. Rregullat për vlerësimin duhet të publikohen në faqen zyrtare të blerësit dhe në platformën e IT-së.

7. I gjithë informacioni bashkëlidhur procedurës së blerjes së energjisë elektrike së bashku me kontratën e nënshkruar nga blerësi dhe ofertuesi/ofertuesit fitues, duhet të dokumentohet dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi. Ai duhet të paraqitet në ERE sipas nenit 19 të rregullores.

Neni 15

#### **Përsëritja e procesit të ofertës**

1. Në rastin kur më pak se tre tregtarë kanë paraqitur ofertat, procesi do të përsëritet.

2. Kur rishikimi, vlerësimi dhe krahasimi nga blerësi nuk është i mundur për shkak të formatit të informacionit të ofertës dhe/ose kur informacioni kërkon sqarim nga ofertuesi, oferta skualifikohet. Nëse numri i ofertave pas skualifikimeve të mundshme është më poshtë se tre, procesi do të përsëritet serish.

3. Përsëritja e procesit të ofertimit duhet të njoftohet për të gjithë tregtarët e energjisë elektrike dhe të publikohet në platformën *online* dhe faqen zyrtare të blerësit. Përsëritja e procesit duhet të kryhet të paktën dy ditë pas fillimit të procesit të ofertimit dhe dy ditë pas periudhës së njoftimit.

Neni 16

#### **Deklarata e konfliktit të interesave**

Para se të fillojë funksionimi i platformës së IT-së, çdo punonjës i blerësit që i është ngarkuar vendosja në funksion dhe ecuria e platformës së

IT-së duhet të nënshkruajë deklaratën, sipas së cilës ai/ajo duhet të shprehë mungesën e konfliktit të interesit me ofertuesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 17

#### **Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës**

1. Njoftimi i fituesit, i jepet ofertuesit/ve, që ka/kanë paraqitur ofertat fituese në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave. Njoftimi i fituesit të paktën përmban:

- emrin, adresën e ofertuesit;
- periudhën e furnizimit me energji elektrike;
- profilin e furnizimit me energji elektrike;
- sasinë, çmimin/njësi dhe vlerën e kontratës.

2. Pas shpalljes së fituesit, blerësi dhe ofertuesi i shpallur fitues nënshkruajnë kontratën.

Neni 18

#### **Procedura administrative e ankimit**

1. Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim e procedurës administrative, e cila ndiqet për një blerje, kur gjykon se një vendim i blerësit është në kundërshtim me këtë rregullore, duke ndjekur hapat e mëposhtëm.

a) ofertuesi paraqet një ankesë me shkrim përmes platformës *online* ose me *e-mail* blerësit, brenda 24 orësh nga momenti i njoftimit të ofertuesit të skualifikuar ose duke u ankuar për shkeljen.

b) në këtë ankesë, ankimesi duhet të paraqesë emrin dhe adresën, referimin për procedurën konkrete ku ka marrë pjesë, bazën ligjore dhe përshkrimin e shkeljes së pretenduar.

c) kur merr një ankesë, blerësi është i detyruar të miratojë vendimin për pranimin ose jo të ankesës brenda 24 orësh nga marrja e ankesës.

d) kur ankimesi nuk është dakord me trajtimin e ankesës nga blerësi, brenda 5 ditëve pune i drejtohet ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në përputhje me nenin 24 të ligjit për sektorin e energjisë.

e) kur ankimesi nuk është dakord me trajtimin e ankesës nga ERE, ajo mund të kundërshtojë vendimin e ERE-s në gjykatë.





## Neni 19

**Monitorimi i blerjes së energjisë elektrike**

1. Të gjitha veprimet e blerjes së energjisë elektrike do të dokumentohen me saktësi. Asnjë blerje nuk do të kryhet pa dokumentacionin shoqërues të kërkuar.

2. Deri në datën 5 të çdo muaji, blerësi paraqet në ERE një kopje të raportit përmbledhës përfundimtar për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave dhe një kopje të të gjitha ankesave të paraqitura, nëse ka, si dhe përgjigjet për ankesat.

3. Blerësi është i detyruar të paraqesë në mënyrë transparente në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar, për blerjet e energjisë elektrike brenda autoritetit të ERE-s për monitorim.

4. ERE shqyrton të dhënat e paraqitura nga blerësi dhe vlerëson nëse procesi i ofertës në muajin pararendës përputhet me kriteret dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.

5. Në rast se ERE shikon parregullsi në proceset e ofertave, të cilat mund t'i ngarkohen blerësit dhe ofertuesve, ERE mund të vendosë një masë administrative mbështetur në nenin 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

## Neni 20

**Pagesat, faturimi, gjetja e zgjidhjes**

1. I gjithë procesi për gjetjen e një zgjidhjeje do të kryhet brenda 10 ditëve pune pas periudhës së livrimit për çdo blerje të kryer. Pagesa dhe faturimi duhet të bëhet në mënyrë të veçantë për çdo javë kalendarike.

2. Blerësi duhet t'u kalojë çmimin e blerjes tregtarëve të energjisë elektrike brenda tri ditëve pune pas përfundimit të javës e cila ka pasur ndonjë livrim.

3. Çdo ditë ose periudhë livrimi më e vogël se kaq, në rast se periudha e livrimit për blerjen është më e shkurtër, duhet të jetë i paraqitur si zë më vete në faturë. Faturimi duhet të nxirret nga platforma e IT-së dhe do t'i faturohet blerësit.

## Neni 21

**Rishikimi**

Këto rregulla janë objekt rishikimi me vendimin e Bordit të ERE-s, sipas rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

## Neni 22

**Sanksione**

Për shkeljen e këtyre rregullave, kur nuk përbën vepër penale, ERE vepron në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, datë 28.5.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

## Neni 23

**Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM**

**Nr. 104, datë 23.6.2016**

**MBI PËRCAKTIMIN E  
METODOLOGJISË SË VLERAVE  
REFERUESE NË RAST SE TË DHËNAT E  
MATJES JANË PËRKOHËSISHT TË  
PADISPONUESHME DHE TË  
PAARRITSHME, SI DHE MBI  
SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË ERE-s  
NR. 49, DATË 21.10.2004 DHE NR. 146,  
DATË 24.12.2013**

Në mbështetje të neneve 16, 76, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015; nenit 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike të ERE-s, në lidhje me miratimin e “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese” në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013”,

konstatoi:

- Me shkresën e OSHEE sh.a. nr. 10473 prot, datë 2.6.2016, është bërë me dije se deri në datën 30 qershor, OSHEE sh.a. do të realizojë pajisjen me matës të të gjithë klientëve.

- Në nenin 76 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” është parashikuar: “Në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një



periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

- Me shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, “Për miratimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matës jashtë kushtit teknik” dhe nr. 146, datë 24.12.2013, “Mbi kërkesën e “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm për vendosjen e faturimit aforfe përmbushen parashikimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, “Për miratimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matës jashtë kushtit teknik” dhe nr. 146, datë 24.12.2013, “Mbi kërkesën e “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm për vendosjen e faturimit aforfe” dhe të çdo vendimi që bie në kundërshtim me këtë vendim.

2. Në rastet kur furnizuesi konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar apo jashtë kushtit teknik) e bën faturimin duke u bazuar në mesataren mujore të faturimit me matje të 3 muajve respektivë të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 2016.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**

#### VENDIM

**Nr. 105, datë 23.6.2016**

### **MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN/KLASIFIKIMIN E SISTEMEVE TË MBYLLURA TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Ne mbështetje të nenit 71, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin mbi rregulloren “Për përcaktimin/klasifikimin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores “Për përcaktimin /klasifikimin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 336 lekë